Rezervuarët e ujit duhet të llogariten dhe dimesionohen në mënyrë që të sigurojnë sasi uji për një autonomi të kërkuar (ndoshta 1 dite). Specifikimet (sasia, kapaciteti etj) duhet të përcaktohen nga projektuesi në bazë të diagramës së shfrytezimit ditor nga konsumatoret. Pervec rezervuareve te ujit te ftohte sanitar te vendosur ne ambjentin teknik, projekti duhet te permbaje dhe nje depozite uji me renie te lire si dhe lidhjen e tij me ËC-te dhe pisuaret per raste kur mund te kete mungese te energjise elektrike. Vellimi i depozites duhet llogaritur nga projektuesi dhe te kete autonomi te pakten 1 dite.
Cezmat ne nyjet sanitare duhet te jene te tipit me shtypje me kohe te caktuar per te beret e mundur kursimin e ujit, dhe gjithashtu te gjithe mishelatoret e ujit te ngrohte te jene me valvola termostatike

Centrali i pompimit është pjesa më rendësishme e sistemit. Parametrat e pompave duhet të llogariten në përputhje me diagramat ditore të nevojave për ujë dhe konfiguracionit të rrjetit.
Në funksion të tyre duhet llogaritur presioni, prurja, fuqia e pompave si dhe specifikime teknike të tjera. Sistemi duhet projektuar duke parashikuar një stacion pompimi, i cili instalohet në përputhje me kërkesat e projektit.
Rrjeti i shpërndarjes vjen nga stacioni i pompimit në godinën teknike për në nyjet sanitare. Çdo degëzim nga magjistrali kryesor shërben si degë furnizimi ose si

kolonë për një sektorë të caktuar duhet të jetë e pajisur me një valvul ndërprerëse, për të ndërprerë prurjen e ujit në rastet kur kërkohet të ndërhyhet në sistem pa ndërprerë furnizim e konsumatorëve të tjerë . Sistemi i tubave të ujit sanitar kërkon gjitha kërkesat e normave dhe standarteve të përcaktuar. I gjithë rrjeti i shpërndarjes do të termoizolohet për të eleminuar fenomenin e kondensimit dhe do të pajiset me saraçineska ndërprerës aty ku është e nevojshme, në rast ndërhyrje të mundshme apo riparim që mund të kërkohen. Sistemi i tubove të ujit sanitar do të plotesojë kërkesat e normave dhe standarteve të përcaktuar dhe seleksionuar qysh në fazën e projektimit prej stafit inxhinierik si dhe të kërkesave paraprake të investitorit. Tubat duhet të jenë të qëndrueshëm ndaj goditjeve mekanike dhe rezistent ndaj agjentëve atmosferik. Tubot e këtij sistemi janë ndarë në funksion të materialit të tyre si më poshtë:

- Tubo çeliku të zinkuar pa tegel për kolonat;
- Tubo PE–Xa – (Polyetilen i retuikuluar) për shpërndarjen në kate;
- Tuba PPR;
- Tuba PEHD (polietilen me densitet të lartë).

Përpara përdorimit uji sanitar duhet të trajtohet (filtrohet) në bazë të karakteristikave fiziko kimike që ka. Filtrimi mund të jetë:

- Me filtër mekanik;
- Me filtër kartuç;
- Me filtër me rërë;
- Me filtër me karbon;
- Me filtër me ultraviolet.

Impianti i furnizimit me ujë të ngrohtë sanitar

Uji I ngrohte sanitar duhet pergatitur me sistem panelesh diellore per uje te ngrohte, ku duhet marre parasysh se paku 1 m2 panel diellor per cdo 100 litra uje te ngrohte ne dite. Panelet mund te jene ose me system termosifon, pa rezistence elektrike por i projektuar ne menyre te tille qe depozita e panelit te furnizoje direkt boilerin ne tualet, ose me sistem qendror me qarkullim me pompe. Specifikimet minimale te paneleve per tu plotesuar

Akumulimi i ujit të ngrohtë duhet të ketë temperaturë jo më të vogel se 60 °C. Megjithatë, për sigurinë e fëmijeve, për reduktimin e rrezikut nga temperatura shumë e lartë e ujit, rregulloret e ambienteve për kopeshte kërkojnë që temperatura për përdorim (në dalje të pajisjeve hidro-sanitare) nuk duhet të jetë më e lartë se 43 °C për të gjitha pajisjet e ujit të nxehtë. Një gjë e tillë arrihet nëpermjet përzjeries termostatike që kryen mishelatori

Dimensionimi i rrjetit të ujit të ngrohtë sanitar duhet të bëhet në bazë të norma dhe standarteve të projektimit.

Sistemi i ujit sanitar do të shërbejë për të siguruar ujin e ftohtë dhe të ngrohtë nga stacioni i pompimit tek kolektorët dhe mbas kësaj të sigurojë shpërndarjen e ujit në pajisjet e ambienteve sanitare.

Shperndarja e ujit të ngrohtë sanitar realizohet nëpërmjet:

- Linjat e shpërndarjes se ujit të ngrohtë;
- Riqarkullimi i ujit të ngrohtë (nese do zgjidhet varianti me boiler qendror te ujit te ngrohte)
- Kolektoret e furnizimit me ujë (nese do zgjidhet varianti me kolektor nga projektuesi)

85.13 Projekti i plotë i kanalizimeve

Sistemi i shkarkimit të ujrave në tërësinë e tij përmban rrjetin e mbledhjes se ujrave atmosferike,ujrave te zeza, ujrave gri dhe ujrave me permbajtje yndyrore.

- Ujrat atmosferike quhen ujrat që bien mbi sipërfaqen e tokës në formën e reshjeve të lëngëta(shiut) dhe në formë të ngurtë (breshër dhe dëborë).
- Ujrat e zeza quhen të gjithë ujrat që mblidhen nga rrjeti shkarkimit të ujrave të ëc të gjithë shkollave.
- Ujrat gri janë të gjithë ujrat që mblidhen nga rrjeti shkarkimit e lavamaneve, bideve, dusheve, lavatriceve etj.
- Ujrat me përmbajtje yndyrore mblidhen nga rrjeti shkarkimit të të gjithë kuzhinave të godinave të ndryshme.

Në rrjetin e shkarkimit të ujrave në të cilat kemi prani të ujrave yndyrore instalohet impianti i mbledhjes se yndyrerave përpara derdhjes në kolektorin kryesor të shkarkimit të ujrave të zeza.

85.13.1 Dimensonimi i rrjeteve të sistemit shkarkimit, vlerat normative të shkarkimit

Dimensionimi i rrjetit të shkarkimit të ujrave bëhet duke u bazuar në llogaritjen e prurjeve për njësi të shkarkimit të paisjeve të ndryshme, në shpejtësinë e rrjedhjes së lëngjeve në tuba dhe pjerrësia e tubacionit. Rrjedhja e ujit në sistemin e shkarkimit duhet të mos krijojë presione që krijojnë grushte hidraulike në tubacione.Tubat duhet të kenë një diametër të mjaftueshëm që të lejojnë qarkullimin e lirë të ventilimit të ajrit e cila stabilizon presionin e rrjetit.

85.13.2 Vlerat e njësi të shkarkimit sipas aparateve

Çdo pajisje sanitare ,shtë e karakterizuar nga një normë e caktuar e rrjedhjes së ujit, e cila varet nga madhësia dhe kushtet e funksionimit te saj. Normat e dimensonimit në te cilat bazohemi per rrjetin e shkarkimit janë propozuar nga standartet **UNI 9183.**

Tabela 1 – Vlera për njësi shkarkimi për aparaturat (UNI 9183)

Aparaturat	**Njesi shkarkimi**
Vaske (pa dush)	2
Dush (për nje sifon)	2
Dush (për cdo sifon të instaluar bashkë)	3
Lavaman	1

Bidet	2
ËC me kaset	4
ËC me kasetat të futur në mure	8
Lavaman kuzhine	2
Lavaman	3
Lavastovile	2
Lavatrice	2
Pilet dyshemeje	1
Kombinim Lavaman-Bide-Vaske-ËC me kaset	7
Kombinim Lavaman-Bide-Vaske-ËC me kaset të futur në mure	10
Kombinim Lavaman-ËC me kaset	4
Kombinim Lavaman-ËC me kaset të futur në mure	8

Dimensioniet e degëzimeve.
Rrjeti i brendshëm i mbledhjes së ujrave të shkarkimeve të ujrave të zeza është i përbërë nga degëzimet e të gjitha paisjeve sanitare.Nga rrjeti i brendshëm uji dërgohet në kollonën vertikale të shkarkimit. Prurja në një degë është prurja njësi e aparatit i cili do të shkarkojë në degëzim. Diametri percaktohet duke u bazuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2 – Diametri i degëve të shkarkimeve në raport me numrin maksimal të njësive të degëve të shkarkimeve në to (UNI 9183).

Diametri i degëve (mm)	**Ngarkesë totale**
40	3
50	6
65	12
80	20
100	160
125	360
150	620
200	1400

85.13.3

85.13.4 Dimensionet e kolonave të shkarkimit

Një kollonë shkarkimi zakonisht merr degë të ndryshme në kate të ndryshme. Prurjet maksimale e rrjedhjes në një kolonë shkarkimi rriten me rritjen e kateve në të cilat ka degëzime. Për dimensionimin e tubacionit të kollonës vertikale të shkarkimit meret prurja maksimale e rrjedhjës në kollone.

Tabela 3 – Diametrat e kolones se shkarkimit ne raport me numrin maksimal per njesi shkarkimi, numri i kateve dhe ngarkeses ne njesit e shkarkimit te katit me te ngarkuar (UNI 9183)

Diametrat e	**Ndërtuar deri në**	**Ngarkes maksimale**

kollonave (mm)	3 kate	për një kate
50	10	6
65	20	9
80	30	16
100	240	90
125	540	200
150	960	350
200	2200	600
250	3800	1000
300	6000	1500

85.13.5 Ventilimi i rrjeteve të shkarkimit

Ventilimi i rrjetit të ujrave të zeza ka si qëllim kryesor nxjerrjen jashtë të gazrave që mblidhen nga ujrat e zeza, gjithashtu nxit funksonimin normal të sifonit të instaluar në cdo pajisje dhe mbajtjen e tyre nën presion atmosferik. Një sistem efektiv ventilimi është gjithashtu i dobishëm për të penguar formimin e mykut.

Kolonat e ventilimit i ndajmë në katër kategori

- Ventilimi primar
- Ventilim të drejtpërdrejt paralel
- Ventilim paralel I indirekt
- Ventilim sekondar

85.13.6 Përpunimi i ujrave të shkarkimeve

- Përpunimi i ujrave të zeza është një procesi i heqjes së ndotësve përbërës në këto ujra.
- Përpunimi i ujrave të zeza bëhet nëpërmjet ndërtimit të impianteve të pastrimit të ujrave.
- Këto impiante ndërtohen jashtë qëndrave të banuara.
- Pas pastrimit këto ujera merren për përdorim komunal.
-

85.13.7 Materialet e tubave dhe komponenteve kryesor të rrjetit të shkarkimit

Tubacionet e degëzimeve të rrjetit të brendshëm dhe të kollonës të shkarkimeve të ujrave të zeza përdoren nga meteriale të ndryshme, tubacione me presion: geberit me saldim.

tubacione pa presion :Polietilen dhe PVC

Tubacinet e kolektorëve ndahen në tubacione me ngarkesë dhe tubacione pa ngarkesë.

Kur tubacionet kalojnë ne trotuare ose lulishte përdoren tuba të brinjëzuar pa ngarkesë SN4, PVC SN4.

Kur tubacionet kalojnë në trupin e rrugës në të cilën ka ngarkesa dinamike dhe kalojnë makina me tonazh të lartë përdoren tuba të brinjëzuar me ngarkesë SN8, PVC SN8. Materialet duhet të shoqërohen me certifikatat e prodhimit.Bazuar në normat **UNI 9183** dhe **UNI EN 1091.**

Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut

- Dimensionimi i rrjeteve të shkarkimit të çative dhe tarracave.
    - Dimensionimi i ullukëve.
    - Dimensionimi i kollonave zbritëse.
    - Dimensionimi i kolektorëve të tubacioneve.
    - Dimensioni i drenazhimit sipërfaqsor.
- Impiantet e shkarkimit të ujrave të bardha.
    - Ujrat e kondensës.
    - Ujrat aksidentale nga impianti M.K.Z.
    - Ujrat në katet nëntokë, nga infiltrimet etj.
- Rrjetet e shkarkimit të ujrave të shiut dhe elementëve kryesorë.
- Materialet e tubave dhe elementët kryesorë impiantistikë.
- Ruajtja dhe përdorimi i ujrave të shiut.

85.14 Projekti i plotë i mbrojtjes kundra zjarrit dhe shpetimit (MKZSH)

Ky impiant përfshin tërësinë e masave arkitektonike, konstruktive, mekanike dhe elektrike për “Parandalimin, mbrojtjen dhe ndërtimin e Impianteve të Mbrojtjes Kundër Zjarrit”.
Këto masa sipas funksionit dhe mënyrës së aplikimit ndahen në masa të “Mbrojtjes Pasive“ dhe në masa të “Mbrojtjes Aktive”.

- Mbrojtja Pasive, e cila trajton argumentat arkitektonik dhe konstruktiv të parandalimit dhe mbrojtjes nga zjarri, te tilla si Kompartimentizimi i strukturave; Realizimi i rrugëve, shkallëve dhe daljeve të sigurta të shpëtimit; Reduktim i ngarkesës së zjarrit dhe përhapjes së tij. Mbrojtja pasive është subjekt i projekteve arkitektonike dhe konstruktive.
- Mbrojtja Aktive, e cila trajton impiantet e dedektimit e shuarjes së zjarrit, te tilla si impiantin e dedektimit dhe të sinjalizimit në rast zjarri, impiantet e shuarjes së zjarrit, të tipit manuale, impiantin e kontrollit të tymit dhe nxehtësisë. Impiantet e dedektimit do të trajtohen nga impiantet elektrike.

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri do jete me hidrante. Hidrantet duhet te jene te projektuar per prurjen dhe presionin e nevojshem sipas standarteve dhe te jene te kompletuar me te gjithe elementet (kaseta, saracineska, tubi i gomuar etj). Ato duhet te pozicionohen ne menyre te tille qe cdo pike e objektit te mbulohet nga te pakten dy hidrante dhe duhet te jene te vendosur sa me prane rrugeve te kalimit te shpetimit dhe evakuimit (objekti duhet te kete se paku dy rruge te shpetimit dhe evakuimit). Ne rast se ndertesa do kete me shume se nje kat, ne hidrantet e secilit kat duhet vendosur nje valvul per lidhjen e skuadrave te zjarrfikesit.
Hidrantet e brendshem duhet te instalohen në mënyrë të tillë që:

- Të instalohen si të pavarur për cdo kompartimentizim;
- Të pozicionohen në afërsi të daljeve e rrugëve të shpëtimit pa u bërë pengesë;

- Të jenë të pozicionuar në të dy anët e portës nëse ka porte REI;
- Të mbulojnë cdo hapesirë të aktivitetit;
- Cdo hidrant të mbrojë një zone me sipërfaqe deri ne 1000 m²;
- Cdo pikë e zonës së mbrojtur të jetë në distancë maksimale 20 m për hidrantet mural dhe 30 m për naspot;

Hidrantët e zjarrit të jashtëm duhet te jene të tipit kollonë mbi tokë me prurje 350 l/m dhe presion në dalje jo më të vogël se 2.5 bar, janë të përbërë nga një kollonë që del nga nëntoka në të cilën janë pozicionur lidhjet që mundësojnë furnizimin e ujit. Hidranti është i përbërë nga kollona me dy dalje perkatësisht DN 70 dhe DN 100 me tapa të lidhura me zinxhir, dhe çelës manovre (opsional).
Hidrantete kollone siper toke dhe hidrantet nëntoke duhet të instalohen në menyrë të tillë që :

- Të jenë jo më shumë se 60 m larg nga njëri tjetri;
- Jashtë ndërtesës rekomandohet që të përdoret hidrante kollonë sipër toke;
- Aty ku është e mundur të instalohen në korrespodencë me daljet nga ndërtesa në menyrë të tillë që të rezultojnë në pozicion të sigurtë edhe në rast zjarri;
- Distanca e tyre nga muret e jashtme të godinës që mbrojnë varet edhe nga lartësia e saj, por rekomandohet një distancë midis 5 m dhe 10 m .

Lidhja me autopompën është një paisje që ndihmon në shuarjen e zjarrit e lidhur me rrjetin hidrik nëpërmjet të cilës mund të sigurohet ujë për rrjetin hidrik në rast emergjence zjarri. Çdo lidhje me autopompen duhet të sigurojë :

- 1 apo 2 lidhje me diameter jo më të vogël se DN 70;
- Të jetë e fiksuar mirë në muret anësore jashtë godinës, lehtesisht i identifikueshem dhe te ketë akses për makinën e zjarrfikëse;
- Presion në dalje jo më të vogël se 1.2 Mpa.

Rrjeti i furnizimit me ujë duhet të jetë në gjëndje që të sigurojë në cdo kohe prurjen dhe presionin e nevojshëm të kerkuar nga impianti në rast zjarri. Si burim uji mund të shërbeje

- Lidhje fikse nga rrjeti ujësjelles i qytetit i pandërprerë;
- Rezervuare fiks të pashtershme, me sasinë e nevojshme të ujit disponibël në cdo kohë.

Si burim apo rezerve ujore nuk mund të shërbejnë puset, shatërvanet apo lidhje të tjera jo të sigurta. Duhet të merren masa qe uji që shërben si rezervë të mos ketë :

- Alga, apo materiale të tjera sospense(bllokuese)
- Materiale korrozive;

Grupi i pompimit duhet të i pozicionuar në një ambient të mbrojtur, në një nivel me rezervën ujore dhe duhet të kompozohet nga :

- 1 ose 2 pompa sipas normës EN733 së bashku me pompën pilot (jockey) dhe disel.
- Paneli komandimit i paisur me buton në pjesën ballore dhe ekranin LCD.

Duhet të merren masa që furnizimi me energji elektrike të bëhet si nga rrjeti normal edhe nga motogjeneratori.

Rrjeti i shperndarjes përfshin rrjetin nëntokësor, rrjetin e jashtëm në dukje dhe rrjetin e brendshëm të godinës. Preferohet të jetë rrjeti unazor, i pajisur me valvola ndërprerëse kontrolli.
Rrjeti i shpërndarjes duhet të marrë parasysh :

- Të jetë me materiale sipas normave;
- Të jenë të lyer me bojë antindryshk;
- Të jetë i mbrojtur nga zjarri, dëmtimet dhe ngricat;
- Të sigurojnë rezistence mekanike;
- Të merren masa për zonat sizmike, kalimet në mure apo ndarje antizjarr.

Projekti i MNZSH duhet te percaktoje gjithashtu edhe pozicionet dhe pajisjet e nevojshme per evakuimin e tymit (baxho me hapje automatike, ventilatore per nxjerrjen e tymit etj).
Projekti i MNZSH duhet gjithashtu te perfshije sinjalistiken e evakuimit.
Sinjalistika shërben për të ndihmuar personat të gjejnë rrugët e shpëtimit, daljet e emergjencës, pajisjet e shuarjes së zjarrit apo telefonat e emergjencës. Sinjalistika e zjarrit, dimensionet (në varësi të distancës së shikimit), ngjyrat dhe përmasat e tyre janë të përcaktuara në perputhje me normën EN ISO 7010. Sinjalistika gjithashtu duhet të realizohet edhe me mjete të tjera :

- nëpërmjet një sistemi komunikimi zanor;
- nëpërmjet një sipërfaqeje me konsistencë të ndryshme;
- nëpërmjet një kontrasti kromatik në dysheme të cilat janë të dukshme në të gjitha kushtet e ndriçimit.

16. KONSTRUKSIONI

85.15 konstruktiv **6.1 Standartet për projektin**

STANDARDET REFERUESE

Eurocodet

- EC0 Bazat e projektimit të strukturave
- EC1 Ngarkesat në struktura
- EC2 Projektimi i strukturave b/a
- EC7 Projektimi gjeoteknik
- EC8 Projektimi sizmik i strukturave.

Kushtet shqiptare të projektimit dhe konkretisht

- Kushtet teknike të projektimit KTP -1978
- Kushtet teknike të projektimit për ndërtimet antisizmike KTP-N.2-89

Projektimi i shkollave duhet të bazohet në standartet e projektimit të strukturave, dhe mqs në vendin tonë janë akoma në fuqi Kushtet teknike të projektimit të vitit

1978 -1979, të cilat nuk pasqyrojnë zhvillimet dhe normat e fundit të hartuara për këtë qëellim, rekomandojmë që projektimi i shkollave të bëhet duke u mbështetur në normat e Eurocodeve.

Në eurocode janë të percaktuara me detaje llojet e ngarkesave (të përhershme, të përkohëshme, borë dhe erë si dhe kombinimet e tyre) të cilat duhen marë në konsideratë gjatë analizimit të strukturës.

Përveç kësaj, që duhet të jetë baza në projektimin e strukturave të shkollave theksojmë :

Përpara hartimit të projektit duhet të bëhet studim gjeollogjik dhe sizmik për terrenin në të cilin ndërtohet objekti.

Projektimi i shkollave të bëhet me struktura b/a, dhe marka e betonit të përdorur të mos jetë më e vogël se C25/30, ndërsa Çeliku i përdorur të jetë i markës S500 (sidenor) ose ekuivalent me të
(p.sh FeB44k).

Gjithashtu rekomandojmë që themelet dhe shkollave të jenë pllaka b/a, të hidroizoluar nga jashtë.

Soletat e ndërkateve të shkollave të jenë soleta monolite, me trarë të thellë.

DETYRE PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:

“Ndërtim i ri i Shkolle Tip4 në Njësinë Administrative nr. 11
(Sheshi 11/1)

- CONTENTS

DETYRE PROJEKTIMI 54

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME DHE GJENDJA EKZISTUESE E OBJEKTIT 62

2. KËRKESA PROJEKTIMI TË PËRGJITHSHME PËR NDËRTIMIN E SHKOLLËS 73

2.1 Hapësirat kryesore 74

2.1.1 Klasat e mësimit 75

2.1.2 Laboratorët ..... **Error! Bookmark not defined.**

2.1.3 Mobilimi 78

2.1.4 Laboratorët ..... **Error! Bookmark not defined.**

2.1.5 Punëtoritë 85

2.1.6 Dhomat e muzikës dhe të vizatimit ..... **Error! Bookmark not defined.**

2.2 Hapësirat shoqërore 90

2.2.1 Biblioteka 90

2.2.2 Hapësira për shumë qëllime 91

2.2.3 Salla për edukimin fizik 97

2.3 Hapësirat administrative 100

2.3.1 Zyra e drejtorit / Zyra e nëndrejtorit 100

2.3.2 Sekretariati / dhoma për administratën 479

2.3.3 Salla e mësuesve 101

2.3.4 Personeli ndihmës 101

2.4 Hapësirat ndihmëse 102

2.4.1 Ambjentet higjeno-sanitare 102

2.4.2 Kabineti i mjekut 103

2.4.3 Kabineti i psikologut 103

2.5 Ambientet komunikuese, hyrjet, shkallët, korridoret, hollet 104

2.5.1 Korridorët 104

2.5.2 Shkallët 105

2.5.3 Ashensori 105

2.5.4 Holli 105

2.5.5 Depot, kthinat ndihmëse 106

2.5.6 Garderobat ..... **Error! Bookmark not defined.**

3. ORENDITË DHE PAJISJET 113

3.1 Antropometria dhe dimensionet e orendive ..... **Error! Bookmark not defined.**

4. KËRKESA TË VEÇANTA ..... **Error! Bookmark not defined.**

4.1 Projektimi për personat me nevoja të veçanta 137

4.2 Shkolla si Qendër Komunitare 140

4.3 Komoditeti Termik (Temperatura) 141

4.3.1 Përkufizimet dhe terminologjia 141

4.3.2 Përmirësimi i komoditetit termik 142

4.3.3 Kontrolli aktiv i temperaturës 143

4.3.4 Temperatura dhe nivelet e lagështisë ..... **Error! Bookmark not defined.**

4.3.5 Standardi i izolimit 143

4.3.6 Urat termike 144

4.3.7 Kërkesa e vlerave të U(Ë/m²K)(koeficientii transmetimit termik) 145

4.3.8 Dritaret dhe Dyert 145

4.3.9 Kontrolli pasiv i temperaturës 145

4.4 Komoditeti Vizual 148

4.5 Komoditeti Akustik 150

4.6 Ngjyrat dhe përdorimi i tyre 151

4.6.1 Kuptimi i ngjyrave 151

4.6.2 Përdorimi i ngjyrave 152

5. IMPJANISTIKA 153

5.1 Standartet per projektet elektrike ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.2 Impjantistika Mekanike ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.3 Impjanti i mbrojtjes ndaj zjarrit ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.4 Impjanti i furnizimit me ujë sanitar të ftohtë 170

5.5 Impjanti i ujit të ngrohtë sanitar ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.6 Impjanti i shkarkimit të ujrave të zeza dhe të përdoruraError! Bookmark not defined.

5.7 Impjanti i shkarkimit të ujrave të shiut dhe të ujrave të bardhaError! Bookmark not defined.

5.8 Impjanti i ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit (H.V.A.C)Error! Bookmark not defined.

5.9 Impjanti i mbrojtjes ndaj zjarrit ..... Error! Bookmark not defined.

5.9.1 Mbrojtja Pasive ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.2 Mbrojtja Aktive ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.3 Terma dhe përcaktime grafike të kartelave të sinjalistikës dhe simboleve teknike ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.4 Terma dhe përcaktime terminologjike të elementeve konstruktive, distancave, rrugëve të shpëtimit, evakuimit të tymrave dhe mjeteve aktive të sinjalizim-dedektimit dhe shuarjes së zjarrit. ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.5 Klasifikimi i nivelit të rrezikut të zjarrit ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.6 Mjetet portative (bombolat), të shuarjes së zjarrit ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.7 Impjantet me dispositive gjysmë të lëvizshme (hidrantët, naspot) të shuarjes së zjarrit ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.8 Impjantet me dispozitiv të palëvizshëm automatik (sprinklerat) të shuarjes së zjarrit ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.9 Centralet e presurizimit dhe rezerva ujore për shuarjen e zjarrit**Error! Bookmark not defined.**

5.9.10 Rrjeti i shpërndarjes, komponentët kryesorë impiantistikë**Error! Bookmark not defined.**

5.9.11 Impianti i kontrollit dhe evakuimit të tymrave ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.12 Paraqitja grafike dhe dokumentat plotësues të domosdoshëm për hartimin e projektit Mekanik te Mbrojtjes Kundra Zjarrit ... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.13 Roli dhe detyrat e personelit në njohjen, mirëmbajtjen, përdorimin e mjeteve të shuarjes së zjarrit dhe veprimit në rast zjarri ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.9.14 Standartet, normat dhe ligjet normative ndërkombëtare dhe kombëtare**Error! Bookmark not defined.**

5.10 Impjanti i furnizimit me ujë të ftohtë hidro/sanitar (H/S)Error! Bookmark not defined.

5.10.1 Përdorimi i ujit të ftohtë sanitar. ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.2 Nevojat për ujë të ftohtë hidro/sanitar. ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.3 Mënyrat e furnizimit me ujë primar dhe sigurimi i rezervës ujore**Error! Bookmark not defined.**

5.10.4 Centrali i pompimit..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.5 Rrjeti i shpërndarjes, komponentët impiantistikë ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.6 Materialet e tubacioneve dhe komponentë impiantistikë në rrjetet e brendshme..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.7 Filtrimi i ujit sanitar ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.8 Impjanti i ujit të ngrohtë sanitar ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.9 Parametrat e ujit të ngrohtë sanitar ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.10 Nevojat e ujit të ngrohtë sanitar të bëhet sipas standarteve**Error! Bookmark not defined.**

5.10.11 Përgatitja e ujit të ngrohtë sanitar ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.12 Dimensionimi i rrjetit të ujit të ngrohtë sanitar ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.10.13 Rrjeti i shpërndarjes, komponentët impiantistikë .... **Error! Bookmark not defined.**

5. 11 Impjanti i shkarkimit të ujrave të zeza dhe të përdoruraError! Bookmark not defined.

5.11.1 Klasifikimi i shkarkimit të ujërave ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.11.2 Dimensonimi i rrjeteve të sistemit shkarkimit, vlerat normative të shkarkimit 165

5.11.3 Vlerat e njësi të shkarkimit sipas aparateve 166

5.11.4 Dimensionet e kolonave të shkarkimit 167

5.11.5 Ventilimi i rrjeteve të shkarkimit 167

5.11.6 Përpunimi i ujrave të shkarkimeve 168

5.11.7 Materialet e tubave dhe komponenteve kryesor të rrjetit të shkarkimit 168

5.12 Impjanti i ngrohjes, ventilimit, kondicionimit (H.V.A.C)Error! Bookmark not defined.

5.12.1 Të dhënat meteorologjike dhe kushtet e jashtme të mjedisit. 153

5.13 Kushtet e projektimit ..... Error! Bookmark not defined.

5.13.1 Normat projektuese dhe vlerat e rekomanduara të temperaturave të ambienteve 154

5.14 Impjanti i kondicionimit ..... Error! Bookmark not defined.

5.14.1 Ngrohja ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.14.2 Tipologjitë e impjanteve të ngrohjes ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.14.3 Impjantet e ngrohjes ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.14.4 Ftohja ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.14.5 Ventilimi - Ajri i freskët ..... **Error! Bookmark not defined.**

5.15 Centralet termike dhe pajisjet mekanike ..... Error! Bookmark not defined.

5.15.1 Centralet termike 157

5.15.2 Pajsjet mekanike ..... **Error! Bookmark not defined.**

6. KONSTRUKSIONI 171

6.1 Standartet për projektin konstruktiv 171

7. AKSESIBILITETI NGA PERSONAT ME AFTËSI TË VEÇANTA/ BARRIERAT ARKITEKTONIKE ..... **Error! Bookmark not defined.**

MATERIALET QE DO TË SIGUROHEN NGA ENTI PROKURUES

9. Detyra e projektimit për çdo objekt arsimor
10. Studimi i Fizibilitetit për infrastrukturën arsimore parauniversitare

RRUGA E SIGURIMIT TË PROJEKTIT TË PLOTË

i. Faza e projektimit skematik dhe konceptual e cila do të sigurohet <u>nga firmat konkuruese</u>:

- Koncepti i objektit
- Genplan i pergjitshem i objektit dhe sistemimet e jashtme, shkalle 1-500
- Skeme distributive, organizimi i hapesirave te shkolles
- Planimetri e te gjitha kateve te propozuar e mobiluar, shkalle 1-200
- Te pakten nje prerje A-A shkalle 1-200
- Fasadat e objektit, shkalle 1-200
- Te pakten 4 imazhe render te jashtme, 2 imazhe render te hapesirave te brendshme
- Te pakten 1 aksionometri volumentirke ose render
- Relacion i projektit
- Preventiv i plote i ndertim – montimit dhe mobilimit te objektit
- Metodologjinë e zbatimit të punimeve

j. Faza e projektit të zbatimit e cila do të sigurohet <u>nga firmat fituese</u>:

Projekti i paraqitur për “Ndërtimi i ri i shkollës Tip4 në Njësinë Administrative nr. 11 (Sheshi 11/1) duhet të përmbajë:

- Planin e vendosjes së strukturës, i cili do të hartohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë së Tiranës.
- Raportin Teknik arkitektonik dhe konstruktiv.
- Projektin arkitektonik: Fasadat, Planimetritë e objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i tarracës, etj.
- Projektin e konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.
- Plan qarkullimi i personave me aftesi te kufizuar
- Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve.
- Projektin e zbatimit të instalimeve elektrike, të rrjetit telefonik, internetit të shoqëruara me licencën e noteruar të projektuesit.

- Projekt Zbatimin e instalimit te sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit, pranë Prefekturës së Qarkut Tiranë.
- Projektin e sistemimit dhe të gjelbërimit të oborrit, projektin e ambienteve të lodrave;
- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve, pajisjet dhe mobilimi që permban projekti
- Grafikun e punimeve te detajuar sipas zërave të punës.
- Detaje arkitektonike, shtresash, dyer/dritare, mobilje etj
- Materialet e ndërtimit që do të përdoren
- Raport gjeologjik
- Raport Sizmik
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

I gjithë materiali i përgatitur në fazën e projekt zbatimit do të dorëzohet në gjashtë kopje të printuara dhe në mënyrë elektronike me CD.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë

- Licencë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të Regjistrit Tregtar
- Licenca të inxhinierëve projektues, licenca të ekspertit mjedisor + deklarata noteriale të inxhinierëve projektues.
- Planvendosja e objektit në shkallën 1 : 1000 format A3 (kopje origjinale);

VARIANTI 1

Hartimi i Preventivit
Kosto totale e ndërhyrjes do të përcaktohet nga preventivi përfundimtarë i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike duke marrë parasysh edhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuara dhe me çmimet për njësi sipas **Manualit Teknik të Çmimeve në fuqi ose analizat teknike te çmimeve per zërat jashtë manualit.**
85.16

VARIANTI 2

Hartimi i Preventivit
Preventivi i dale nga projekti
Preventivi përfundimtarë i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike duke marrë parasysh edhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuara dhe me çmimet për njësi sipas Manualit Teknik të Çmimeve në fuqi ose analizat teknike te çmimeve per zërat jashtë manualit.

Kosto e ndërtim montimit

Kostoja totale e ndërtim-montim dhe mobilim do te bazohet tek preventivi përfundimtar i objektit duke dhene çmimet e firmës zbatuese per cdo ze te parashikuar ne kete preventiv. Ky preventiv duhet te jete brenda fondit limit te parashikuar nga autoriteti kontraktor. Pikerisht kjo kosto do te jete pjese e ofertës se përgjithshme, ne kete menyre mund te krahasohet cilësia e projektit me cilësinë e zbatimit brenda te njëjtit fond limit.

85.17

Standardet

85.18

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës. Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për ketë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Rekomandime për projektuesin

- Projekti do të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me grupin e ngritur brenda Bashkisë Tiranë për konsultimin dhe mbikëqyrjen e procesit të projektimit.
- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku do te ndërtohet shkolla. Të dhënat e nevojshme për projektim, siç janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, planin rregullues të zonës, etj, duhet të sigurohen nga projektuesi përmes aplikimeve për informacion në institucionet përkatëse.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Tiranës.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit arkitektonik
- Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.) si dhe masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha

llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e investitorit.

- Relacionin sizmologjik të truallit (kur nuk ka studim, një përshkrim i përgjithshëm)
- Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.
- Preventivi i plotë i punimeve të zbatimit
- Relacioni gjeologjik dhe vetitë fiziko-mekanike të dherave ku duhet të paraqiten cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit të ri dhe atij ekzistues.
- Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.

Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet në fazë projekt zbatimi duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

97. Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje) dhe relacioni përkatës
98. Planimetria e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
99. Planimetritë e kateve të objektit, Shk. 1:100, 1:50
100. Fasadat e reja në 2 D dhe në 3D Shk.1:100
101. Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100
102. Planimetria e themeleve Shk.1:100
103. Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10
104. Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50
105. Planimetritë e mobilimit të shkollës Shk.1:100
106. Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100
107. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20
108. Planimetria e furnizimit me ujë në Shk. 1: 200, 1:100
109. Skemat aksonometrike e furnizimit me ujë, detaje të paisjeve hidrosanitare Shk.1:100
110. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10
111. Planimetria, aksonometria dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100
112. Planimetria dhe detaje të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100
113. Planimetria e dhomës së kaldajës, konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50
114. Planimetri dhe detaje për ndriçimin, fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50
115. Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objekti, Shk. 1:100
116. Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50
117. Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50
118. Planimetria e ambienteve sportive dhe ambienteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50.
119. Planimetria e murit rrethues, tipin dhe detajin e fiksimit të stolave, Shk.1:100; 1:50.
120. Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse
shk. 1:100; 1:50.

Në fletët e vizatimit të konstruksionit të objektit duhet të jepen dhe tabelat e specifikimit për çdo material, hekur, beton, tulla etj.

REFERENCAT

Referenca te pergjithshme

- Udhëzimet ekzistuese për shkollat P të Shqipërisë, të cilët tashmë përdoren si dokumente referuese nga planifikuesit, projektuesit dhe mbikëqyrësit e zonave të punës;
- Ligji për arsimin i MAS-it;
- Normat ISO për ndërtimtari;
- Ligjet e tjera të Shqipërisë, duke përfshirë Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për planifikimin e territorit, rregulloret për mbrojtje nga zjarri; Ligjin e ndërtimit; Udhëzimi për Kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar; Rregullore teknike për kursimin e energjisë termike dhe mbrojtjen termike në ndërtesa;
- Kurrikulumi i ri për arsimin e përgjithshëm;
- Projekte të ndryshme standarde për ndërtimin e shkollave në Shqipëri dhe
- Udhëzime të tjera të përgatitura paraprakisht nga konsulenti.

Referenca speficike

- VKM nr.319, dt 12.04.2017, "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave"

- VKM nr.98, Dt. 06.02.2013, "Për miratimin e listës së Standardeve të Harmonizuara Shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e konformitetit për produktet e ndërtimit

- Normat ISO për ndërtimet.

- VKM, Nr. 68, datë 15.2.2001, Për "Miratimin e Standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit".

- VKM, Nr. 1503, Dt. 19.11.2008, Për miratimin e rregullores " Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar".

- Urdhër i Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr. 425, Dt. 24.07.2015 "Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes kundër zjarrit dhe për shëptimin dhe lëshimin e akteve teknike"

- Urdhër i Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr. 424, Dt. 24.07.2015 "Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në ndërtimet e destinuara për banim".

- Ligji, Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".

- Ligji, Nr.107/2014, Dt. 31.07.2014 "Për planifikimin e territorit"

- Ligji, Nr. 69/2012, Dt.21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

- VKM. Nr. 408, Dt. 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

- VKM. Nr, 626, Dt. 15.07.2015 “Normativat e projektimit të banesave”.

- VKM. Nr, 628, Dt. 15.07.2015 “Rregullat teknike të projektimit dhe të ndërtimit të rrugëve”.

- VKM. Nr, 691, Dt. 29.07.2015 “Strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”.

- VKM. Nr.38, Dt. 16.01.2003 “Për miratimin e normave, të rregullave dhe kushteve të projektimin dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtes së nxehtësisë në ndërtesa”.

- Dispozitat normative pëër Sistemin arsimor parauniversitar. MAS. Tiranë, 2013.

- Zevi, B. Architectura-Zevi, Il Nuovissimo Manuale Dell Architetto.

- Neufert, E. & P. Architectural Standard

Elektriket

- CEI 0-2 Udhëzues për përcaktimin e dokumentacionit
- CEI 11-35 Udhëzues për ekzekutimin e kabinave elektrike
- CEI 11-1 Impiante elektrike për tensionet alternative më të mëdha se 1 kV.
- CEI 11-17 Impiante të Prodhimit, Transportit dhe Shpërndarjes së energjisë elektrike, Linjat elektrike.
- CEI 11-20 Impiante të Prodhimit të energjisë alternative, grupet e elektrogjeneratorëve të lidhur në rrjete të kategorisë I dhe II.
- CEI 11-25 Rrymat e lidhjes së shkurtër, në sistemet trefazore alternative. Llogaritjet e tyre.
- CEI 11-26 Rrymat e lidhjes së shkurtër, llogaritja e efekteve. Definicione dhe metoda e llogaritjeve.
- CEI 17-13/1 Siguria e pajisjeve të manovrimit në tension të ulët (Kuadrot e tensionit të ulët)
- CEI 31-30, 31/33, 31/35 Konstruksionet elektrike të pajisjeve të instaluara në zona me mundësi eksplozioni nga prezenca e gazit. Klasifikimi i zonave të rrezikshme.
- CEI 64-8/1 Përdorimi i impianteve elektrike në tensione nominale jo më të mëdha se 1000 V alternativ dhe 15000 V të vazhduar.
- CEI 81-10/1-4 Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike (rrufe).

- CEI 103-1/1 a 103.1/16 Impiantet telefonike të brendshme.
- CEI te CT 210 (pajtueshmërinë elektromagnetike) dhe CT 211 (ekspozimi i njeriut ndaj fushave elektromagnetike).
- UNI EN 12464-I Sistemet e ndriçimit të brendshëm, të posteve të punës.
- UNI Standard 9795 - Sistemet fikse të zbulimit dhe sinjalizimit automatik dhe alarmit të zjarrit.
- UNI EN 1838 Pajisjet e ndriçimit, Ndriçimi i emergjencës.
- CEI EN 50173-1 Teknologjia e informacionit- Sistemet e kabllimit të përgjithshëm, -Planifikime dhe kriteret e instalimeve brenda ambienteve të brendshme.
- IEC 60076-11 Përdorimi i transformatorëve trefazorë të thatë .
- IEC 103-1 / N PABX central.
- 60617/1-2 Simbolet CEI EN – Grafikat e përdorura për diagrame etj.
- CEI 3-8 Shkurtime dhe simbole për skicat në plane.
- CEI Përdoruesit elektrikë 64-8/1-2-3-etj.
- CEI / UNI Të produkteve që aplikohen për projektimin, ndërtimin, testimin në fabrikë dhe instalimin e materialeve, komponentëve dhe pajisjet elektrike.

Mekaniket

- UNI/EN 12845 Norma të përgjithshme për mbrojtjen nga zjarri;
- UNI 10779 Rrjeti i hidranteve. Projektimi, instalimi dhe përdorimi;
- EN 671 Sistemet fikse të mbrojtjes nga zjarri. Tubacionet fleksibël antizjarr;
- EN 54-1 Sistemi i detektimi dhe i alarmit të sistemit – Hyrje;
- EN 54-3 Sistemi i detektimi dhe i alarmit të sistemit – Pajisjet e alarmit;
- EN 12723 Pompat – Terma të përgjithshme të pompave dhe instalimeve,
  definicione, sasi, simbole dhe njësi;
- EN 60529 Shkalla e mbrojtjes (Kodi IP) (IEC 60529:1989);
- ISO 65 Tuba çeliku me filetim në përputhje me Standardin ISO 7-1;
- EN 12094 Sisteme të shuarjes me gaz;
- EN 12094 Sisteme të shuarjes me gaz;
- EN 1356 Sistem të shuarjes me shkumë;
- UNI 9994-1 Bombolat portative;
- UNI EN 12416-2 Impiantet me pluhur;
- UNI EN 13565-2 Impiantet me shkumë;
- UNI ISO 15779 Sistemet e shuarjes me aerosol.

Konstruktive

- EC0 Bazat e projektimit të strukturave
- EC1 Ngarkesat në struktura
- EC2 Projektimi i strukturave b/a
- EC7 Projektimi gjeoteknik

- EC8 Projektimi sizmik i strukturave.
- Kushtet teknike të projektimit KTP -1978
- Kushtet teknike të projektimit për ndërtimet antisizmike KTP-N.2-89

TERMAT

Termat e përdorura në këtë detyre projektimi i referohen terminologjisë së përcaktuar në Ligjin Nr. 69/2012, Dt.21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

TermAt arkitekturale/të inxhinierisë

- Komoditeti akustik: Kushtet akustike në të cilat shkolla dhe shfrytëzuesit e saj mund të veprojnë me efikasitetin maksimal.

- Hapësirat administrative: Hapësirë fizike e shkollës e dedikuar për aktivitete administrative.

- Hapësirat e qarkullimit: Hapësirë e caktuar për qarkullimin horizontal dhe vertikal brenda ndërtesës, si hollët e hyrjes, korridoret dhe shkallët.

- Komoditeti klimatik: Kushtet mjedisore në të cilat shkolla dhe shfrytëzuesit e saj mund të veprojnë me efikasitetin maksimal.

- Hapësirat arsimore: Hapësira fizike e shkollës e cila i dedikohet aktiviteteve edukative.

- Mjedisi higjienik: Kushtet e përgjithshme të higjienës në shkollë që ndikojnë në nivelin e komoditetit dhe shëndetin e shfrytëzuesve dhe varen nga kushtet fizike të ndërtesave sanitare, furnizimi me ujë, rezervat e ujit dhe sistemi i largimit dhe trajtimit të ujërave të zeza të cilat mundësojnë që ndërtesa shkollore të funksionon në mënyrë efikase dhe të sigurt.

- Orientimi: Orientimi i ndërtesës shkollore (pjesa e hapësirave arsimore), që ndikohet nga faktorët natyrorë klimatikë, si dielli dhe drejtimi i erës.

- Lokacioni i ndërtesës shkollore: Sipërfaqja e tokës brenda së cilës janë të vendosura ndërtesat arsimore.

- Hapësirat ndihmëse: Hapësirat fizike në ndërtesë shkollore të dedikuara për mbështetje të aktiviteteve arsimore dhe ato administrative.

17. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME DHE GJENDJA EKZISTUESE E OBJEKTIT

Vendndodhja: Sheshi i propozuar nr. 11/1 për ndërtimin e shkollës tip 2 dhe tip 4 ndodhet brenda kompleksit universitar të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ky shesh kufizohet nga rruga “Taulantët” dhe bulevardi “Blu”. Njësia Administrative nr. 11.(Referuar Studimit të Fizibilitetit "*Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë*" Nëntor 2016). Kjo shkollë ndodhet në Njësinë Administrative 11, dhe lidhet me aksin e rrugës urbane kryesore ‘’Kastriotët’’ dhe rrugës urbane dytësore ‘’Paisi Vodica’’ dhe rrugës urbane dytësore ‘’Hamit Keçi’’.

Përshkrim i sheshit: Sheshi 11/1 ndodhet në një zonë të paprekur dhe me gjelbërim të ulët, ka pjerrësi të konsiderueshme. Aksesi në të është i vështirë dhe problematike është infrastruktura rrugore, ka një sipërfaqe rreth 5,928 m^2. Relievi ku është vendosur ky shesh karakterizohet nga formacione kodrinore me pjerrësi të ulët. Ky shesh nuk ka KUZ, ndërsa përsa i përket ujësjellësit ka në Lindje-Tub160PE, në Jug-Tub63PE dhe në Perëndim- Tub75PE.

Figura 5 *Vendodhja e sheshit 11/1 sipas studimit te fizibilitetit*

Figura 2- Foto të sheshit 11/1



Figura 3 – Harta kadastrale e sheshit 11/1

18. KËRKESA PROJEKTIMI TË PËRGJITHSHME PËR NDËRTIMIN E SHKOLLËS

Në këtë territor do të ndërtohen:

A. Shkolla për arsimin e mesëm të lartë urban (**Tipi 4**)

Ndërtimi i këtyre objekteve do të plotësojë mungesat e objekteve arsimore në këtë zonë, si dhe do të ndikojë në uljen e numrit të nxënësve në shkollat ekzistuese të cilat ndodhen në kufijtë e kësaj njësie.

Shkolla për arsimin e mesëm të lartë duhet të ketë të gjitha ambientet e nevojshme akademike (klasat mësimore duke përfshirë laboratorët e fizikës,

kimisë, biologjisë, informatikës etj), palestër me ambientet ndihmëse të saj, hapësirat administrative, hapësirat shoqërore, etj. Objekti duhet të ketë të instaluar sistemin e ngrohjes qendrore dhe MKZ. Sistemimit të oborrit të shkollës duhet ti kushtohet një rëndësi e veçantë. Ambienti i jashtëm duhet të jetë i sistemuar, duke përfshire ambjentet funksionale përkatëse, terrenet sportive, me gjelbërim dhe me ndriçim të jashtëm

Funksionaliteti

Gjatë projektimit të ndërtesës shkollore, duhet të krijohet një bilanc mes cilësisë së funksionimit dhe efikasitetit të kostos. Ky bilanc mund të arrihet me mjete të ndryshme, siç janë:
Dimensionet racionale të hapësirave:

(xxi) Zonat e përshtatura të qarkullimit: hapësirat e qarkullimit nuk duhet të kalojnë 25% të sipërfaqes së dobishme të ndërtuar. Ato duhet të kenë dimensione dhe të përshtaten sipas shfrytëzuesve të shkollës, ato duhet të jenë funksionale dhe të respektojnë kërkesat për siguri;

(xxii) Numri optimal i hapësirave: numri i hapësirave fillimisht përcaktohet sipas shfrytëzimit.Në shkollat e vogla ku norma e pranueshme nuk mund të arrihet, në veçanti për hapësirat për mësimdhënie të specializuar, hapësirat për qëllime të shumëfishta duhet të merren parasysh;

(xxiii) Përshtatshmëri maksimale: hapësirat duhet të projektohen me një përshtatshmëri maksimale, që i mundëson ato të përshtaten për lëndë dhe ndryshime të ndryshme, në ato raste kur kjo përshtatet me kërkesat e tyre funksionale;

(xxiv) Grupimi i hapësirave: hapësirat duhet të grupohen në blloqe sipas funksionit dhe ndërlidhjes. Kjo do të siguronte një identifikim të lehtë të veprimtarive dhe hapësirave të tyre korresponduese, një komunikim të lehtë mes hapësirave të ndryshme, pa pengesa nëpër zonat e qarkullimit dhe ato të pritjes, një vëzhgim të lehtë të hapësirave dhe një shfrytëzim optimal të tokës në dispozicion;

(xxv) Integrimi i nevojave: lokacioni i hapësirave brenda shkollës duhet të ndjekë domosdoshmëritë themelore siç janë rregullat e sanitarisë dhe higjienës, rregulloret e komoditetit funksional dhe të sigurisë, si dhe komoditetin akustik, vizual e atë klimatik.

Fleksibiliteti

Dizajneri/projektuesi do të duhet të projektojë hapësira të mjaftueshme për fleksibilitet për t'i mundësuar

(ix) personelit të shkollës që të përshtatet me ambientin e shkollës dhe me metodat e ndryshme të mësimdhënies; dhe

(x) për t'i mundësuar planifikuesve që të adaptohen me ndërtesat për nevojat e ardhshme të shkollës që korrespondojnë me kurrikulumin e mundshëm dhe programet me ardhshme. a) Fleksibiliteti i kërkuar për ndërtesa (dhe orenditë) që mundëson metoda të shumta të mësimdhënies për

klasat e zakonshme (mësimi frontal, puna në grupe të vogla, mësimi në formë të seminareve etj.) laboratorë dhe salla të specializuara (puna praktike në gjysmë grupe, kurse demonstrimi në grupe të plota) si dhe hapësirat për qëllime të shumëfishta dhe hallat e sporteve (mundësia e rigrupimit të disa klasave).

2.1 Hapësirat kryesore

Referuar Studimit të Fizibilitetit "*Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë*" (Nëntor 2016), **Tipi 4** i shkollave, është i mesëm i lartë, për zonat urbane me 21 klasa.

Për realizimin e projektit sipas tipologjisë së shkollës dhe vendit ku do të ndërtohet, referuar “*Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore normat dhe standardet*”. të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duhet të merren parasysh këto parametra kryesore:
Arsimi i Mesëm i Lartë, klasa 10 – 12, mosha 17- 19 vjeç;

Numri i cikleve (paraleleve): 7

Numri i Klasave: 21

Numri i nxënësve/klasë 30

Numri total i nxënësve 630

Të dhënat e mësipërme në mënyrë të përmbledhur janë në Tabelën 4.

Tabela 4[5]

Tipi	Vendndodhja	Cikli	Nr. klasash	Nx/Klasë	Nr. nx. total
Tipi 4	Urban	Arsimi i mesëm i lartë	21	30	630

85.19
85.20

85.20.1 2.1.1 Klasat e mësimit

Në projektimin e klasave të mësimit duhet të llogaritet një sipërfaqe 1.94 m^2 / nxënës - 2.18 m^2 / nxënës (optimale) për dhomat e zakonshme të mësimit dhe 1.8 m^2 / nxënës për dhoma të specializuar te mësimit. Lartësia minimale e klasave (dysheme-tavan e përfunduar) duhet të jetë 2.8 m.

[5] *Referuar Tabelës nr 2, Faqe 44_ Studimi i Fizibilitetit "Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë Tiranë" Nëntor 2016 dhe Shtojcës V1II5 për shkolla standarde për arsimin e mesme të lartë- viset urbane. Udhëzueis për projektimin e ndërtesave shkollore normat dhe standardet” të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës*

50	Sensor temperature	1 copë	Shkalla: -30/+1350C Rezolucioni: 0.10C Shpeshtësia: mbi 10 matje/s Lidhet me smartboard. Komandohet me touchscreen. E109 .
51	Sensor i trysnise së gazit		Kërkon sinjal proporcional me trysninë e gazit. Vlera e kërkuar është 156.050 kPa. Njësia matëse e trysnisë mund të jetë Bar, kPa, atm. Shpeshtësia është 100 matje në sekondë dhe shkalla 0-200 kPa. Lidhet me smartboard. Komandohet me touchscreen. Grumbullimi dhe hedhja e të dhënave me USB. Lidhje permanente me kordë.
52	Motor me djegie të brendshme	1 copë	
53	Termometër (0-50) gradë Celsius	10 copë	Shkallëzimi (0-50) gradë me zhivë
54	Termometra (0-200) gradë Celsius	10 copë	Shkallëzimi (0-200) gradë me zhivë
55	Termometra (-10-110) gradë Celsius	10 copë	Shkallëzimi (-10-110) gradë me zhivë
	ELEKTRICITETI DHE MAGNETIZMI		
56	Ampermetër laboratorik	4 copë	Shkalla e matjes -0,2~0~0,6A / -1~0~3A, ndjeshmëria 75 mV, Përmasa afërsisht (133 x 97 x 100)mm
57	Ampermetër-voltmetër për demostrime	1 komplet	DC rryma evazhduar,1mA,100mA,1A,10A, DC tensioni (0-10)V,(0-30)V AC/alternative 10mmA,100ma,1A,5A AC tensioni 10V,30V,250V
58	Aparat për shpërndarjen e ngarkesës elektrike	1 copë	Sferë metalike e montuar mbi një dorezë izoluese
59	Aparat për veprimin e forcës magnetike mbi përcjellësin me rrymë	1 copë	Përmasat: afërsisht (500x250x270) mm I=2A
60	Aparat për demostrimin e Ligjit të Kulonit	1 copë	Bazamenti metalik, fija me palcë shtogu
61	Aparat për demostrimin e vijave të fushës magnetike		Kuti me përmasa (98x55x55)mm, me tunel, diametër i brendshëm 10mm dhe gjatësi 70mm dhe shufër magnetike me përmasa(50x7)mm gjateëi.
62	Burim drite (bateri)	5 copë	3 V, 4,5V
63	Busullë mësimore shkollore	1 copë	Diametër jo më pak se (50) mm
64	Bobina Rumkorf	1 copë	220V/50Hz,dalja (20-100)Kv,distance 100mm
65	Çift bobinash induksioni	3 komplete	Bobina primare ø35mm, gjatësia 120mm dhe 380 spira dhe bobina sekondare ø65mm,481 spira , si dhe me bërthamë hekuri
66	Çelës thike me kasetë	1 copë	Tension 36V dhe rrymë të vazhdueshme 6A

67	Çelës për qarkun elektrik	5 copë	U= 36V me rrymë të vazhdueshme 0-3A
68	Fije percjellese	10 copë	50cm gjatësi me spina fundore dyanëshe
69	Elektroskop me fletë	1 copë	Diametër jo me i vogël se200mm, me mbështetës me material plastik ose prej qelqi
70	Elektromagnet në formë patkoi	1 copë	Përbëhet nga dy bobina, njera me bërthamë prej shufre celiku ne forme U, me nje armature metalike mbyllëse me çengel dhe tension 6V dhe rrymë 1A.
71	Gjilpërë magnetike me suport	3 copë	Gjatësia e gjilpërës jo më pak se 40mm
72	Gjilpëra magnetike të vogla	3 copë	gjatësia jo më e vogël se 30 mm
73	Gypa plastikë	6 copë	Prej materiali plastik
74	Kafazi i Faradeit	1 copë	Përmasat (600x300x150)mm
75	Kabllo përcjellëse me spina fundore	10 copë	Me gjatësi 50cm dhe spina fundore dyanëshe
76	Kondensator me disqe	10 copë	Disqe pecigllas me diameter (200-300)mm
77	Kuti rezistencash montuar në kasetë	1 komplet	10x0,1Ω; 10 x 1 Ω; 10x10 Ω; 10x100 Ω; 10x1000 Ω
78	Llambushka	25 copë	Tip standard, 6V
79	Mbajtëse llambushkash	1 komplet	Bazament plastik , me portollambë U= (0-30)V, I=(0-3) A
80	Modeli i gjeneratorit trefazor	1 copë	Dalja > ose = 8V kur shpejtësia rrotulluese afërsisht 1600 rrot/minutë
81	Maketi i një elektromotori	1 copë	Përmasat 50cmx50cm
82	Pendolini elektrizues	1 copë	Suport plastik me fije mëndafshi
83	Magnet në formë patkoi	2 copë	80mmx200mm, 0,05T80mm x 200mm2, 0,05T.
84	Magnet i thjeshtë	4 copë	5x25cm
85	Pajisje për dëndësine e ngarkesave	1 copë	Përmasat (600x300x150)mm
86	Pila e Voltës	3 copë	Me shufër karboni, pllakë bakri, pllakë plumbi, pllake zinku
87	Përcjellës drejtvizor me pllakë plastike	1 copë	Përbëhet nga tre përcjellësa të ndryshëm, bazamentet plastikë
88	Rekord për urën Ëinston	1 copë	(1000x100x50)mm, tel Ni-Cr
89	Reostat 50U me kursor (me rrëshqitje)	1 copë	Rezistenca (0-50) om, rryma1.5A
90	Rrjeta elektrostatike	1 copë	
91	Rrezet katodike	1 copë	(640x440x590)mmm me support plastik
92	Sistem burimesh alternative B46		Përdoret për eksperimente të ndryshme për studimin e energjive të ripërtërishme, si diellore, hidrike dhe të erës. Përbëhet nga panel diellor, turbinë me erë, turbinë hidraulike, qelizë me hidrogjen, ventilator, elikë. Përmasat 50x45x15 cm. Pesha 5.5 kg
93	Seri fijesh metalike, montuar mbi pllakë	1 komplet	Materiali i fijeve: hekur, bakër, nikel-krom
94	Sferë me dorezë izoluese	1 copë	Doreza plastike ose sfera metalike me diameter jo mëtë vogël se ø50mm
95	Shufër qelqi	2 copë	Gjatësia jo më e vogël se 300 mm
96	Shufër ebaniti	1 copë	Gjatësia jo më e vogël se 300 mm
97	Shufër shkarkuese	10 copë	Bishti plastmase - shufra metalike (500-700)mm
98	Shufër magnetike	2 copë	Me pole të ngjyrosur 160mm, 0,06 T (160 x 200) mm, 0.06T.
99	Spektrat magnetikë	1 copë	(500x330x250)mm
100	Stimulues i sigurisë elektrike		Simulon problemet teknike të sistemit elektrik: qarkun e shkurtër, rrjedhjen e rrymës, mbingarkesën dhe siguresën.

			Vendoset në një kasë alumini e mbushur me foam. Dimensionet afërsisht: 30x35x10 cm.
101	Sensor i tensionit dhe rrymës	1 copë	Sensor I kombinuar.Shpeshtësia e matjeve 50000matje/s.lidhet me smartboard.Komandohet me touchscreen.
102	Transfomator	1 copë	
103	Tuba geisler (burim drite me gaze të ndryshme)	1 komplet	Tubat me hidrogjen, oksigjen, helium,dyoksid karboni, neon, argon.
104	Ushqyes universal (0-24)V, 6A	1 copë	Daljet e rrymës alternative dhe tëvazhduar (2-24)V me 12 shkalle. Rryma maksimale e punës deri në 6A. Përmasat afërsisht (270 x 120 x 210) mm, 6,5 kg
105	Volmetër laboratorik	3 copë	Shkalla e matjes -5~15V, ndjeshmëria 1mA. Përmasat afërsisht (133 x 97 x 100)mm
	AKUSTIKA, LËKUNDJET, VALËT		
106	Aparat për demostrimin e dukurisë së përhapjes së valëve	1 copë	Tensioni (0-6)V; numri i vibrimeve 13; ø i vibratorit 15,6mm, përrmasat (450mmx200mmx300mm)
107	Diapazon 440Hz	1 copë	Përbëhet nga : dy pirunj me të njëjtën frekuencë 440 Hz, me seksion tërthor (6,5 x 16)mm, gjatësia e krahëve 109 mm, distanca midis 17mm,
108	Lavjerrës matematik	1 copë	Sferë e varur në një fill të pazgjatshëm, e fiskuar në një bazament
109	Lavjerrës për rezonancë	5 copë	5 lavjerresa me gjatësi të ndryshme, korniza metalike (400 x 300) mm.
110	Kuti rezonance	1 kuti	e përshtatshme për diapazon 440 Hz; afërsisht 145x88x53 mm
111	Komplet sustash	1 komplet	Përdoren për demonstrimin e valëve gjatësore dhe tërthore. Susta 1 me diametër 8 cm, gjatësia e pazgjatur 13 cm, mund të zgjatet deri afërsisht 5 m, pesha 0.6 kg. Susta 2 me diametër 2 cm, e pazgjatur me gjatësi 1 m, pesha 0.5 kg.
112	Sonometër me tri korda		Përdoret për hulumtimin e varësisë së tingullit nga gjatësia, tensioni dhe trashësia e kordës vibruese. Përbëhet nga një kuti rezonance prej druri me gjatësi 60 cm, me shkallëzime. Kompletohet me dinamometër, dy korda çeliku me diameter, Φ0,4 mm, një kordë çeliku me diameter,Φ0,8 mm dhe tri urëza të lëvizshme për përshtatjen e gjatësisë së kordave.
113	Tubi Kundt	1 copë	Tub qelqi me gjatësi 1,5 m dhe diametër 35mm,shufër druri 390mm gjatësi,bazament pre druri me gjatësi 1,5 m dhe diameter 13mm.
114	Pajisje për studimin e valëve elektromagnetike		Transmetues valësh: diodë Gunn 10.7GHz (λ=2.8cm), fuqi 30Ë tension (10-12)V në (2 - 3.5)V. Kasa cilindrike me diametër 83mm dhe gjatësi 70mm. Gjatësia e përgjithme 225 mm. Marres valesh: I ngjashëm ne ndertim me transmetuesin. Detektori sonde: diode mikrovalesh silikoni e njejte me marresin por e montuar ne nje shufer te shkurter, vertikale, jo metalike. Baza e sondës me 4 prizaper lidhjen me

			qarkun e jashtëm me permasa(75x50x135)m.
115	Stroboskop		Përdoret për të vrojtuar dukuri që ndodhin shumë shpejt. Përmasat (20x12x14) cm, pesha 1.8 kg. Frekuenca (1-300) Hz.
	OPTIKA		
116	Lazer He-Ne		Përdoret për eksperimentet e difraksionit dhe interferencës. Përmasat 35x10x14 cm, pesha 1.5 kg, drita e kuqe koherente, gjatësia e valës 633 nm
117	Aksesorë per eksperimente analoge optike		Sipërfaqe pasqyruese(200x300)mm, (60x300)mm, pllakë qelqi me faqe paralele(200x300)mm, rrjetë polarizimi (200x200)mm, thjerrë plan-konvekse me zgaver që gjatë punës mbushet me vaj parafine, thjerrë plan-konvekse me zgavër mbushet me vaj parafine; prizëm me zgaver mbushet me vaj parafine (45x90x45)grade ;
118	Aparat fotografik	1 copë	Digital, cyber shot, mbi 10 Mega pixel.
119	Disk optik	1 copë	Disku me ngjyra me litar rrotullues Përdoret për zbërthimin e dritës së bardhë.perbëhet nga disku me diametër 200 mm, me dy sete spektresh me ngjyra, një rotor me dorezë që e rrotullon. Boshti i dorezës përputhet me boshtin e diskut. Vendoset mbi një bazë plastike me përmasa afërsisht (120x120) mm, me këmbëza gome, lartësia e përgjithshme afërsisht 32 cm.
120	Pasqyrë e lugët	2 copë	Prej qelqi F' = 65mm, ø=100mm
121	Pasqyrë e mysët	2 copë	Prej qelqi F' = 65mm, ø=100mm
122	Pasqyrë e rrafshët	1 copë	Largësi vatrore f=65mm, ø = 100 mm
123	Filtra me ngjyra të ndryshme	1 komplet	Plastike, 40x20 mm7 ngjyrat baze te spektrit, me dimensione afërsisht 535x310 mm secili filter
124	Modeli i syrit		Pamja fizike e funksionimit të syrit, përfshirë defektet e të parit dhe korrigjimin e tyre. I montuar në bazament druri ose plastik dhe ka përmasa jo më të vogla se (320 x 180)mm
125	Kaleidoskop		Diametër (180 x 35)mm
126	Thjerrë përmbledhëse	2 copë	Prej qelqi
127	Thjerrë shpërndarëse	2 copë	Prej qelqi
128	Thjerrë plan-mysët	2 copë	Prej qelqi
129	Prizëm prej qelqi	1 copë	Pika e pamjes 85^0, 25mm-75mm / 50mm-15mm
130	Pllakë qelqi me faqe paralele	1 copë	Përmasat (50x20)mm
131	Rrjetë qeramike	1 copë	1235x125 mm dhe 150x150mm
132	Qelq zmadhues	2 copë	Me zmadhim jo më të vogël se 4 herë
133	Sensor i dritës		Shkalla: (0 -2 000)lux / (0 -30 000) lux Rezolucioni: 0.5 lux/10 lux Shpeshtësia: mbi 1000 matje/s Lidhet me smartboard. Komandohet me touchscreen.
	FIZIKA MODERNE		
134	Monitor rrezatimi (α, β, γ)		Përbëhet nga tubi Geiger-Myler dhe matës shpeshtësie i montuar në një kuti plastike të vogël, të gomuar me një metër analog. Njësia punon me bateri dhe mund të përdoret pa kompjuter për matjen e rrezatimit α, β, γ. Mund të

			përdoret për të marrë statistika të rrezatimit, për të matur shpeshtësinë e zbërthimit të bërthamës dhe për të monitoruar shndërrimet e radonit
135	**TË PËRGJITHSHME**		
136	Alkool	1 shishe	1kg alkool në shishe qelqi
137	Acid sulfurik	1 shishe	250 gram në shishe qelqi
138	Bekera qelqi	10 copë	100ml, 250ml,500ml, prej qelqi
139	Cilindra të shkallëzuar	10 copë	25ml, 100ml,500ml, prej qelqi
140	Disku me ngjyra	1 copë	Disk me ngjyra me litar rrotullues, diametër 200mm
141	Erëmatës	1 copë	Plastik ose inoks
142	Ene qelqi me forma të ndryshme, por me vëllim të njëjtë	5 copë	100ml, 250ml,500ml, prej qelqi
143	Enë qelqi me forma dhe vëllime të ndryshme	5 copë	100ml, 250ml,500ml, prej qelqi
144	Gurë peshimi me çengela	1 komplet	Kuti me 10gurë metalik, 50gr.secili
145	Gota kimike	5 copë	Gotë kimike 50 ml 100 ml 250 ml
146	Gyp plastik me diametër të ndryshëm	5 copë	Transparentë, ø = 6-8 mm
147	Gyp qelqi i vogël në formë U-je	5 copë	ø = 16mm, h= 150mm
148	Gërshërë punëdore	1 copë	Prej hekuri me dorezë plastike, gjatësi 10cm
149	Hinka qelqi	3 copë	Prej qelqi
150	Kapëse provëzash	1 copë	Prej druri
151	Llamba me alkool	4 copë	Prej qelqi me alkool, me kapak dhe fitil
152	Lapsa me ngjyra	2 paketa	Kuti me lapsa me ngjyra druri dhe uji
153	Lapustila me ngjyra	5 copë	Lapustila me ngjyra
154	Llastik	10 m	Llastik i hollë
155	Lugë për substanca	2 copë	Prej qelqi, inoks, plastike
156	Mbajtëse provëzash	2 komplete	Prej druri
157	Mikroskop	1 copë	Mikroskop i thjeshtë
158	Naftalinë	200 gr.	Reagent kimik i pastër
159	Nivel tregues	1 copë	Dru pse material plastik, me flluskë ajri
160	Ngjitëse	2 copë	Ngjitëse të vogla dhe të mëdha
161	Parafinë	250 gr.	Reagent kimik i pastër
162	Pikatore	3 copë	Qelqi me kapese gome, rreth 10cm
163	Plastelinë	1 pako	Me ngjyra 70x150mm
164	Pluhur hekuri	200 gr.	Reagent kimik i pastër
165	Peshore teknike me gurë peshimi	1 copë	Peshore e thjeshtë me pjata
166	Provëza	6 copë	Prej qelqi, 12x100mm
167	Poça koneke me vëllime të ndryshme	3 copë	Vëllimi100 ml 250 ml 500ml
168	Pe-plumbi	1 copë	Plumb i varur në fije
169	Pjata petri	4 copë	Me material prej petri
170	Poça sferikë me vëllime të ndryshme	4 copë	Vëllimi100 ml 250 ml 500ml
171	Raportor plastik	1 copë	Tip standard, bazamenti 50cm
172	Spango	10 m	Fije e pazgjatshme
173	Sfera të madhësive të ndryshme	10 copë	Përmasat me diameter (50-100) mm
174	Suport plastik me fije mëndafshi	1 copë	Përmasat (500x300x250)mm
175	Susta	1 komplet	Diametër 8 cm, gjatësia 13 cm,pesha 0,6 kg
176	Trazues qelqi	2 copë	Prej qelqi, 30-50 cm
177	Tullumbace	10 copë	Me ngjyra të ndryshme
178	Topa pingpongu,tenisi, futbolli	3 copë	Topa pingpongu,tenisi, futbolli
179	Rrjeta qeramike	1 copë	125x125mm ose 150x150mm
180	Sulfat bakri	1 shishe	250gram
181	Shishe qelqi për lëngje	5 copë	Vëllimi 60ml, 100ml
182	Shiringa plastikë	3 copë	Të mëdha, plastike
183	Shi-matës	1 copë	Plastik ose inoks , klasik PVC
184	Acid sulfurik	1 shishe	250gram
185	Vizore e gjatë plastike	1 copë	Përmasat 100 cm
186	Vizore trekëndore	1 copë	Përmasat (30x40x50) cm
187	Xhama sahati	2 copë	Prej qelqi
188	**TABELA MËSIMORE**		

“Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës në Zonën Tirana 1”

189	Sistemi ndërkombëtar i njësive SI	1 copë	Përmasat (70x100)cm
190	Madhësitë fizike themelore	1 copë	Përmasat (70x100)cm
191	Proceset termodinamike	1 copë	Përmasat (70x100)cm
192	Cikli I i Karnoit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
193	Konstantet themelore në natyrë	1 copë	Përmasat (70x100)cm
194	Transformimet e Lorencit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
195	Tabela e Mendelejevit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
196	Parimi i punës së frigoriferit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
197	Qendra e gravitetit dhe kushtet e ekuilibrit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
198	Lëvizja e predhës	1 copë	Përmasat (70x100)cm
199	Proceset termodinamike	1 copë	Përmasat (70x100)cm
200	Shndërrimet e gjendjeve të lëndës	1 copë	Përmasat (70x100)cm
201	Fusha magnetike	1 copë	Përmasat (70x100)cm
202	Toka si magnet	1 copë	Përmasat (70x100)cm
203	Shndërrimet fazore të lëngjeve	1 copë	Përmasat (70x100)cm
204	Bymimi i trupave të ngurtë	1 copë	Përmasat (70x100)cm
205	Elektromotori	1 copë	Përmasat (70x100)cm
206	Transformatori	1 copë	Përmasat (70x100)cm
207	Modeli i gjeneratorit trefazor	1 copë	Përmasat (70x100)cm
208	Modeli i ziles elektrike	1 copë	permasat (70x1000cm
209	Parimi i gjeneratorit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
210	Induksioni elektromagnetik	1 copë	Përmasat (70x100)cm
211	Tensioni elektrik	1 copë	Përmasat (70x100)cm
212	Ligji i Ohmit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
213	Elektromagneti	1 copë	Përmasat (70x100)cm
214	Fusha magnetike e solenoidit me rrymë	1 copë	Përmasat (70x100)cm
215	Lidhja e përcjellësve në paralel	1 copë	Përmasat (70x100)cm
216	Rregulla e dorës së majtë	1 copë	Përmasat (70x100)cm
217	Eklispi i Hënës	1 copë	Përmasat (70x100)cm
218	Glob (paraqitja fizike dhe politike)	1 copë	Me bazament në tavolinë ose në tokë
219	Dhoma e errët	1 copë	Përmasat (70x100)cm
220	Elekstroskopi	1 copë	Përmasat (70x100)cm
221	Qark i lidhjes në seri	1 copë	Përmasat (70x100)cm
222	Qark i lidhjes në paralel	1 copë	Përmasat (70x100)cm
223	Qark e integruar me lidhje të përzier	1 copë	Përmasat (70x100)cm
224	Qark me lidhje të shkurtër	1 copë	Përmasat (70x100)cm
225	Forca e Amperit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
226	Dioda kristalore	1 copë	Përmasat (70x100)cm
227	Tranzistori	1 copë	Përmasat (70x100)cm
228	Spektrat magnetikë të gazeve	1 copë	Përmasat (70x100)cm
229	Ndërtimi i atomit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
230	Galvanometri	1 copë	Përmasat (70x100)cm
231	Eksperimenti i Tomsonit për rrezet katodike	1 copë	Përmasat (70x100)cm
232	Skema e prodhimit të energjisë nga hidrocentrali te shtëpitë	1 copë	Përmasat (70x100)cm
233	Sistemi hidraulik i frenave	1 copë	Përmasat (70x100)cm
234	Sistemi diellor dhe planetët	1 copë	Përmasat (70x100)cm
235	Përthyerja e rrezeve të dritës nga prizmi prej qelqi	1 copë	Përmasat (70x100)cm
236	Ligji i pasqyrimit dhe i përthyerjes	1 copë	Përmasat (70x100)cm
237	Pasqyrimi i plotë i brendshëm	1 copë	Përmasat (70x100)cm
238	Eksperimenti me çarjet e Jungut	1 copë	Përmasat (70x100)cm
239	Polarizimi i dritës	1 copë	Përmasat (70x100)cm
240	Dispersioni i dritës	1 copë	Përmasat (70x100)cm
241	Spektrat (me vija, të vazhduar, të absorbimit)	1 copë	Përmasat (70x100)cm
242	Zbërthimi i dritës së bardhë dhe bashkimi i ngjyrave	1 copë	Përmasat (70x100)cm
243	Qarku hidraulik dhe elektrik	1 copë	Përmasat (70x100)cm
244	Mikroskopi elektronik	1 copë	Përmasat (70x100)cm
245	Mikroskopi elektronik	1 copë	Përmasat (70x100)cm
246	Diagrama e niveleve energjetikë të atomit të hidrogjenit	1 copë	Përmasat (70x100)cm
247	Diagrama lazer	1 copë	Përmasat (70x100)cm
248	Seritë e zberthimit të bërthamave	1 copë	Përmasat (70x100)cm
249	Reaksioni bërthamor	1 copë	Përmasat (70x100)cm

250	Reaksioni zinxhir	1 copë	Përmasat (70x100)cm
251	Rezonanca magnetike	1 copë	Përmasat (70x100)cm
252	Diagram e ciklotronit		Përmasat (70x100)cm
253	Parimi i punës i motorit me avull	1 copë	Përmasat (70x100)cm
	MJETE TË SIGURISË		
254	Syze mbrojtëse plastike	1 copë	Masa per fëmijë
255	Kutia e ndihmës së shpejtë (mjete të sigurisë gjatë punës në laborator)	1 komplet	Kuti e tipit klasik e ndihmës së shpejtë

86.1 4.1 Projektimi për personat me nevoja të veçanta

Projektimi/dizajnimi i ndërtesave shkollore duhet të siguroj qasjen e papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe mësimnxënies të nxënësve me nevoja të veçanta, referuar legjislacionit perkates, per kete kategori. prandaj, projektuesit duhen të bazohen në këtë legjislacion por edhe në këtë udhëzues ku jane paraqitur kushtet teknike më specifike për ndërtesat shkollore. Llojet e nevoja të veçanta për të cilat mund të përkujdesemi në një shkollë standarde do të kufizohen, për arsye praktike, në ato me nevoja të veçanta në lëvizje, humbje të dëgjimit që korrigjohet me pajimet për dëgjim, dhe humbja e pjesërishme ose e tërësishme e të parit, pas trajnimit adekuat. Mirëpo, kategoria e fundit nuk do të jetë në gjendje të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet shkollore të mësimdhënies ose të mësimnxënies.

Personat me nevoja të veçanta mund të jenë nxënës, arsimtarë, mysafirë ose personel. Problemi i tyre kryesore është reduktuara në lëvizshmërinë e tyre për arsye se ata shfrytëzojnë karrocat e invalidëve, patericat ose bastunët. Ky problem kërkon dimensionim të veçantë të zonave të qarkullimit, hapësirave të dyerve, pajisjeve sanitare, shtigjeve të evakuimit dhe hapësirave të klasave për tu akomoduar personat me nevoja të veçanta.

Dimensionet e personave me nevoja të veçantë nëpër karrocat e invalidëve duhet të kihen parasysh nga projektuesit gjatë caktimit të madhësisë së hapësirave të shkollës dhe qarkullimit. Karrocat e invalidëve kanë dimensione të ndryshme, sipas moshës së nxënësve dhe llojit të artikullit. Megjithatë, dimensionet e mëposhtme, përkojnë me dimensionet mesatare të personave të rritur, e që duhet të merren parasysh (shih fig. 1.3.13 dhe 3.14) :

- Gjerësia e karriges përgjithësisht është mes 600 dhe 700 mm
- Gjatësia është mes 1000 dhe 1250 mm
- Rrezja e jashtme është mes 1300 dhe 1500 mm



Fig. 1.3.13

Hapësira deri ku mbërrijnë personat me nevoja të veçanta në karrocat e invalidëve definohet:

- Mes 230 dhe 300 mm mbi nivelin e dyshemesë;
- Mes 1100 dhe 1300 në lartësi;
- Mes 300 dhe 400 mm nga pjesët anësore të karriges;



Fig. 3.14

Qasja në hapësirat dhe ndërtesat e jashtme

(i) Qarkullimi i jashtëm

- Parkim i posaçëm për automjete duhet të parashihet me një hapësirë më të madhë në njërën anë (3.80 m në vend se të jetë 2.5 m gjerësi);
- Kufijtë e shtigjeve të këmbësorëve duhet gjithmonë të kenë skaje të ndërprera dhe hapësirat për këmbësorë gjithmonë duhet të jenë të ndara nga trafiku i automjeteve me gurë (blloqe) trotuaresh;
- Shtigjet duhet të respektojnë minimumin e kërkuar me gjerësi prej 1.5 m për një karrocë standarde invalidësh, sipërfaqja për kthim dhe mbulesat e dyshemesë duhet të jenë bërë nga materiale kundër-rrëshqitëse dhe të jenë të lira nga pengesat ndaj lëvizjes së lehtë;
- Lakorja e pjerrtësisë në rruginën ku ecet nuk duhet të jetë më e pjerrët se 1:12 ose 5% dhe pjerrinat e gjata duhet të jenë të ndara në faza;
- Trotuaret duhet të kenë minimum gjerësinë prej 0.90 m nëse janë të projektuara për një kahje dhe 1.80 m për të dyja kahjet;
- Sinjalizimi duhet të jetë i dukshëm dhe racionalisht i vazhdueshëm;
- Qasja në të gjitha ndërtesat duhet të jetë e arritshme nga personat me nevoja të veçanta mundësisht me platforma, pjerrina e të cilave nuk duhet të tejkalojnë 1:12 (5%) me pushimore të rrafshët pas çdo 9 m gjatësi të platformës;
- Të gjitha kalimet nëpër fushat e lojërave dhe fushat sportive duhet të jenë të projektuara me platforma sa herë që një gjë e tillë është e nevojshme. Pjesa përfundimtare e këtyre platformave duhet të jetë e bërë nga materiale kundër-rrëshqitëse siç janë blloqet e betonit, gurët ose asfalti;
- Platformat duhet të jenë të pajisura me nga një parmak anësor dhe/ose bllok trotuari përgjatë gjatësisë së platformës;

(j) Hapësirat e brendshme

- Hyrjet kryesore të ndërtesave duhet të jenë qartazi të dallueshme, të lehta për tu hapur dhe të thjeshta për të kaluar përmes tyre;
- Pragjet e dyerve duhet të evitohen ose të kenë lartësinë maksimale prej 20 mm;
- Në hapësirat e mësimdhënies, hapësira e punës me diametër prej 1.5 m duhet të mbahet e lirë dhe e pangarkuar, ashtu që karroca e invalidëve të mund të kthehet dhe të pozicionohet para tavolinës;
- Dërrasat e shkrimit duhet të jenë të kapshme nga pozita ulur. Dërrasa, lartësia e së cilës mund të rregullohet mund të jetë një opsion;
- Ndërrimet e vogla në nivel duhet të shmangen. Aty ku janë të pashmangshme, platformat e vogla janë më të preferueshme se shkallët;

- Për t’ju vene ne ndihme nxënësve me shikim të dobësuar, dyer tërësisht të glazuara duhet të shmangen, ngjyra të ndryshme duhet të përdoren në shkallët për pushimoret dhe shkallët, dritaret në fund të korridoreve duhet të shmangen (kontrasti I tepruar në ndriçim);

- Ashensori(ët) duhet të vendosen afër hyrjes së ndërtesës, hapësira e ashensorit duhet të jetë mjaft e madhe për karroca të invalidëve, ndërsa shenjat dhe kontrolli duhet të jenë të arritshme nga personat me nevoja të veçanta. Kabina e ashensorit duhet të përmbajë edhe shenjëzimet si: alfabeti i Braille , pranimi akustik dhe vizual i thirrjes dhe lajmërimi me zë në kat.

86.2 4.2 Shkolla si Qendër Komunitare

Nisma “Shkolla si Qendër Komunitare” është shkolla e hapur ndaj komunitetit, shkolla që vihet në shërbim të plotë të komunitetit, pa cenuar procesin e mësimdhënies, duke e plotësuar atë përtej orarit zyrtar.
Per kete eshte e nevojshme qe projektuesi te mendoje per programin e funksioneve te shkolles edhe aksesin nga komuniteti jashte orarit zyrtar te shkolles. Zgjidhjet arkitektonike duhet te jete te tilla qe ofrojne fleksibilitet duke arritur ne te njejten kohe sigurine ne shkolla, e nga ana tjeter pas mesimit ambjentet e saj te jete lehtesisht te skesueshme.
Shkollat perfshire territorin e tyre duhet te ndahen ne 3 kategori privatesie. A. Funksione teresisht per shkollen, nxenesit dhe stafin e shkolles. B. Hapesira per shkollen por edhe per komunitetin. C. Hapesira terisht per komunitetin.

- A.Funksione teresisht per shkollen jane ato funskione qe do te perdoren vetem nga nxenesit dhe stafi i shkolles, te tilla si klasat, laboratoret, mjediset e stafit etj. Duhet te garantohet hyrja e tille qe te plotesoj sigurine e nevojshme te ketyre ambejnteve, te limitohen hyrjet dhe daljet, te jene lehtesisht te kontrollueshme.

- B. Hapesirat per shkollen dhe per komunitetin jane ato funksione qe do te sherbejne ne orarin mesimore per nxenesit dhe stafin dhe ne oraret pas mesimit zyrtar per komunitetin. Keto funksione jane, palestra, hapesirat per shume qellime (auditori, salla e koncerteve, ekpozita, mbledhje prinderish etj), Bibloteka. Ne keto raste duhet te mendohet menaxhimi i aksesit. Projektuesi duhet ti projektoje keto hapesira duke krijuar kases te lehte per komunitetin, mundesisht te drejtperdrejt nga jashte pa kompromentuar hapesirat si koridore apo klasat. Keto ambjente duhet te kene tualete te perdorshme nga komuniteti. Projektuesi duhet te mendoje per keto hapesira specifike sesi mund te funksionojne edhe te integruara me shkollen, por edhe ne menyre te vecante dhe te pavarur.
  Gjithashtu oborri i shkolles te mendohet fleksibel duke pasur parasysh sigurine e e shkolles por ne te njejten kohe, te jete lehtesisht i transformueshem ne hapesire publike e perdorshme nga i gjithe

komuniteti pas orarit te mesimit. Qe do te thote, aksesi te jete i lehjte, rrethimi, te jete trasprent mjaftueshem, si dhe porta hyrese sa me e madhe. Te jete me gjelberim dhe peme per te krijuar hije mjaftueshem, stola per tu ulur si dhe ndricim urban edhe per naten.

- C. Hapesira teresisht per komunitetin, jane ato hapesire qe ne oraret e funksionimit te shkolles ose jo jane gjithmone te aksesueshme per komunitetin. Projektuesi duhet te mendoje qe nje pjese nga oborri i shkolles, qe perkon edhe me hyrjen ne kete oborr te krijoje hapesire publike ku kjo sherben sin je hapesire publike per komunitetin, ku nxenesit e perdorin jashe orarit mesimore, ku prinderit sjellin dhe presin femijet nga shkolla et. Te jete me gjelberim dhe peme per te krijuar hije mjaftueshem, stola per tu ulur si dhe ndricim urban edhe per naten.

86.3
86.4 4.3 Komoditeti Termik (Temperatura)

86.4.1 4.3.1 Përkufizimet dhe terminologjia

Komoditeti termik zakonisht i atribuohet dy parametrave kryesorë: (1) ndjenjës së komoditetit termik si rezultat i bilancit mes kalorive të akumuluara dhe të humbura në trup, dhe (2) kontrollit të kushteve termike, duke përfshirë pozitën e diellit dhe rrezatimit, temperaturën, lagështinë dhe erërat. Projektuesit e ndërtesave të shkollave duhet të marrin parasysh kushtet termike të zonës ku parashihet të bëhet ndërtimi. Në këto udhëzime janë paraqitur të përgjithshme në lidhje me kushtet termike në Shqipëri, por të dhëna shtesë dhe më të detajuara duhet të grumbullohen për kushtet e sakta të zonave përkatëse, siç janë: (1) minimumi dhe maksimumi i temperaturës mesatare mujore, (2) higrometria lokale, dhe (3) erërat mbizotëruese për çdo stinë klimatike dhe shpeshtësia e erërave forta dhe stuhive.

86.4.2

86.4.3 4.3.2 Përmirësimi i komoditetit termik

Për të përmirësuar komoditetin termik të hapësirave të shkollës, masat e mundshme për kontrollin e temperaturës janë klasifikuar në dy kategori:
Masat **natyrore** ose pasive, që përfshijnë orientimin e ndërtesës, pozitën dhe dimensionet e hapjeve, cilësinë e materialeve, izolimin termik, mbjelljen e pemëve në afërsi të ndërtesave etj.
Masat **artificiale** ose aktive, që përfshijnë mjetet mekanike ose ato elektrike, siç është ngrohja, ajrosja.
Persa i perket sistemit te ngrohjes, te perdoren sistemi i kaldajes ku si lende te pare perdoret pelleta.

Persa i perket sistemit te ftohjes, shkolla duhet te projektohet ne menyre te atille qe te garantoje nje temperature te ajrit 26°C qe është kufiri për punë komode në

shkolla, ku me lëvizjen e duhur të ajrit nga rrjedha e ajrit natyror, nga dritaret e hapura dhe qarkullueset e ajrit, këto nivele zakonisht mund të arrihen në klasat gjatë vitit.

Ventilimi i objektit te projektohet i tille qe te garantoje cilesine e ajrit permes ventilimit natyror. Ne ambjentet qe ventilimi natyrior nuk eshte i mundur, ateher te mendohet zgjidhja nepermjet sistemeve artificiale te ventilimit.

Për kontrollin e efekteve termike në hapësirat e shkollës, projektuesit duhet të ndërmarrin disa masa të thjeshta në fillim të procesit të projektimit. Këto masa kanë të bëjnë me:

- **Orientimin e ndërtesave**: rekomandohet që orientimi i hapësirave të klasave të jetë drejt lindjes dhe perëndimit meqë ky orientim ofron mbrojtje nga rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ky orientim i preferuar mund të devijojë për rreth minus ose plus 30° (për shkak të kërkesave të lokacionit, ose për shkak të orientimit të erërave mbizotëruese) pa pasur ndonjë ndikim të madh në komoditetin e klasave mësimore (shih figurën më poshtë);
- **Vendosjen e ndërtesave**: largësia mes ndërtesave duhet të jetë në proporcion me lartësinë e ndërtesave për të lejuar qarkullimin e ajrit të pastër dhe dritën natyrore edhe në nivelet më të ulëta. Për të njëjtat arsye, një largësi minimale prej 4m duhet të mbahet në mes të faqeve kryesore dhe murit rrethues. Gjithashtu fasada jugore e shkollës nuk duhet të jetë më afër se 10m nga ndërtesa më e afërt me të.
- **Formën dhe dizajnin** e ndërtesave, si për shembull, mundësia e qarkullimit të tërthortë të ajrit për ripërtëritjen e ajrit të freskët me ajrosje natyrore gjatë stinës së nxehtë, ose zgjedhja e kulmit me katër nivele të pjerrësisë në zonat me reshje të mëdha të dëborës;
- **Sipërfaqet e mbjella**: mbjellja e bimëve mund të luajë një rol thelbësor në krijimin e mikroklimës, kur është e nevojshme. Mbjellja e bimëve kontribuon në mënyrë efektive në mbrojtjen nga pluhuri, erërat dhe rrezet e diellit. Përveç kësaj, mbjellja e shkurreve dhe kaçubeve bëjnë të mundur mbrojtjen kundër reflektimit të rrezeve të diellit nga toka;
- **Elementet e duhura të ndërtesës**: kjo përfshin kullimin e duhur nga çatia dhe kullimin rreth ndërtesave, krijimin e hijeve me kanate të rregullueshme nëpër dritare, ndalesa të diellit, perde për diell, çadra dhe/apo galeri që mund të sjellin mbrojtje shtesë nga rrezet e diellit, sidomos kur orientimi i ndërtesës nuk është i favorshëm.

Materialet e duhura të ndërtimit, që përfshijnë materialet e fasadave me reflektim të mundshëm të diellit, materialet izoluese për rritjen e veprimit termik të mureve dhe të kulmit, me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e nxënësve.

86.4.4 4.3.3 Kontrolli aktiv i temperaturës

- **Temperaturat e ulëta:** niveli komod i temperaturave më të ulëta mund të konsiderohet ai mes 19°C, për vendet ku ushtrohen veprimtari të punës që nuk përfshijnë lëvizje, dhe 15°C, për zonat e qarkullimit. Përpjekjet për të siguruar nxehtësi në mënyrë që të arrihen këto nivele të temperaturave në mjediset e brendshme, zakonisht nuk duhet të jenë shumë të larta. Megjithatë, një minimum shumë më i ulët mund të ndodhë në secilin prej muajve të sezonit të ngrohjes, ku sistemi i ngrohjes duhet të ketë kapacitetet të reagimit ndaj këtyre temperaturave të ulëta.

- **Temperaturat e larta**: Klima e Shqipërisë është kryesisht e thatë dhe e nxehtë nga maji deri në shtator, ku shumica e ditëve gjatë kësaj periudhe janë me diell. Muajt më të nxehtë janë korriku dhe gushti me variacione rajonale për shkak të lartësisë. Megjithatë, temperaturate ajrit 26°C është kufiri për punë komode në shkolla, ku me lëvizjen e duhur të ajrit nga rrjedha e ajrit natyror, nga dritaret e hapura dhe qarkullueset e ajrit, këto nivele zakonisht mund të arrihen në klasat gjatë vitit.

86.4.5 4.3.5 Standardi i izolimit

Sa më i mirë të jetë termoizolimi i një elementi konstruktiv të jashtëm përballë ajrit të jashtëm, aq më e vogël është mundësia e daljes së ajrittë ngrohtë jashtë. Elementët konstruktive të izoluara keq, kanë temperaturë të ulët të sipërfaqeve të brendshme; sa më i keq të jetë ky izolim aq më i madh është rreziku që në sipërfaqe nën ndikimin e një lagështie të shëndetshme relative të ajrit prej 40-60%, temperature kritike minimale zbret nën 12,6 °C.
Vëmendje të veçantë duhet tu kushtohet zonave të ashtuquajtura ura termike si p.sh. tavanet e mureve të jashtëm, pasi këtu temperatura e sipërfaqes mund të jetë më e ulët se sa ajo e elementeve konstruktive në zonat e rregullta.

86.4.6 4.3.6 Urat termike

86.4.7

Urat termike janë pika të dobëta termike të lokalizuara në mbulesën transmetuese termike të ndërtesës. Në krahasim me sipërfaqet e pashqetësuara të elementeve konstruktive, në këto pika ndodh një humbje e madhe termike nga brenda jashtë. Sa më i lartë standardi energjitik i një ndërtese, aq me rëndësi është eleminimi i urave termike.

- **Llojet e urave termike**

  - Urat termike gjeometrike të kushtëzuara krijohen, nëse madhësia e sipërfaqeve thithëse dhe çliruese termike ndryshojnë, si p.sh. në këndet e jashtme të ndërtesës, trashësitë e ndryshme të elementit konstruktiv ose kollonave të dala.
  - Urat termike të kushtëzuara nga lloji i materialit krijohen gjatë përdorimit të materialeve me përçueshmëri të ndryshme termike dhe me këto karakteristika të ndryshme izoluese, të cilat mund të janë të vendosura në krah ose mbi njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë, në vendin e

materialit të ndërtimit me përçueshmëri më të lartë termike krijohet një rrymë termike më e lartë. Një shembull tipik janë elementet konstruktive prej betoni brenda një muri të jashtëm me tullë.

- Urat termike konvektive krijohen kur energjia termike e një rryme ajri transportohet nëpërmjet mbulesës së ndërtesës përçuese termike. Ato shkaktohen nga mos hermetizimet e sipërfaqes. Bashkimet e hapura të shtresës izoluese në zonën e çatisë apo mosizolimi i fugave të dritareve janë shembuj të krijimit të këtyre urave termike.

Një numër i madh i urave termike mund të mënjanohen nëpërmjet punës së mirë projektuese, supervizimit të kujdesshëm dhe nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve të duhura.

- **Këshilla gjatë projektimit**
  - Të mënjanohen strukturat me shumë degëzime;
  - Të vendosen ndarje termike të elementeve konstruktive konsol (pllakat e ballkonit, kollonat, konsolat mbajtëse) me strukturat në kufi;
  - Shtresa të pandërprera të materialit izolues p.sh. sistemet termozioluese të mureve të jashtme dhe kalimet e niveleve të veçanta izoluese pa dobësim të vlerave termoizoluese.

86.4.8 4.3.7 Kërkesa e vlerave të U(Ë/m²K)(koeficientii transmetimit termik)

Sipas legjislacionit ne fuqi (Ligji Nr. 8937 dt. 12.09.2002 „Per ruajtjen e nxehetesise ne ndertesa" dhe akteve nenligjore perkatese VKM Nr. 38 dt. 16.01.2003 „Per miratimin e normave, rregullave dhe kushteve te projektimit dhe te ndertimit, te prodhimit dhe ruajtjes se nxehetesise ne ndertesa") per zonen klimatike A te ciles i perket Tirana (me pak se 1500 Grade Dite Ngrohje ne vit) Koeficienti i humbjeve volumore Gv per ndertesa eshte midis 0.54 – 1.03 Ë/m³°C. Vlera me e vogel eshte per ndertesa me raport S/V (siperfaqe te jashtme/volum i ngrohur) me te vogel se 0.3 dhe vlera me e larte per ndertesa me raport S/V me te madh se 0.9. Per ndertesa me S/V ndermjet ketyre vlerave, koeficienti Gv llogaritet proporcionalisht. Ne menyre qe koeficienti I humbjeve volumore te plotesoje kerkesat e ligjit duke respektuar njekohesisht dhe kriterin ekonomik kosto-perfitim, eshte llogaritur qe ndertesat ne Tirane duhet te kene nje shtrese termoizolimi te jashtem (tip kapote) polisterol EPS me trashesi 5 cm (U = 0.35 Ë/m^{0}K) ose me fiber minerale me te njetet parametra te transmetimit te nxehetesise dhe me dritare me dopjo-xham (6 x 12 x 6 mm) me profil plastic ose alumin me termoizolim. **Shtresa termoizoluese duhet te jete e instaluar nga jashte** dhe te respektohen me rigorozitet kerkesat e prodhuesve per menyren e fiksimit (pervec materialit ngjites edhe me sistem montimi me vida-upa plastik) si dhe shtresa e barrieres se avujve te ujit. Cdo menyre tjeter instalimi rrezikon te shkatoje kondensim ne muret e brendshme, krijim myku, dhe demtim te shtreses se termoizolimit.

86.4.9 4.3.8 Dritaret dhe Dyert

Depërtimi i dritës natyrale në mjediset e brendshme, fushëpamja e lirë nga brenda jashtë ndërtesës dhe fushëpamja e lirë brenda të gjithë ndërtesës janë elemente mjaft të rëndësishme në mjediset për nxënësit.
Dritaret duhen vendosur si në muret që ndajnë klasat nga Mjediset e jashtme, klasat nga klasa dhe klasat me korridorete brendshme.
Për të përmbushur këto kërkesa duhet të merren parasysh si nxënësit ashtu edhe mësueset / sit . Duhet tu kushtohet rëndësi elementeve si lartësia dhe kornizat e dritareve, lloji i xhamit, qartësia e pamjes (të mos të bllokohet horizontalisht si nga të rriturit ashtu edhe nga nxënësit), kontrolli i dritës, impakti i vlerësimit të riskut, si dhe faktorët e sigurisë. Vlerësimi i sigurisë mund të rekomandojë që stacioni i rojës të pozicionohet brenda qendrës në mënyrë që hyrjet dhe daljet të mund të monitorohen nga rojet e ndërtesës. Ose mund të rekomandohet ndonjë formë alternative për këtë. Projektuesi duhet të përpiqet që të planifikojë të paktën një dritare të jashtme për klasë. Në rast se kjo nuk mund të bëhet por hapësira e brendshme duhet të zihet nga nxënësit, projektimi duhet të parashikojë depërtimin më të mirë të dritës dhe pamjes nëpërmjet vetratave, dritareve anësore, dritareve dhe dyerve me xham (të sigurta). Hapësirat e nxënësve në ndërtimet e reja duhet të kenë një sipërfaqe totale me dritare prej së paku:

- 8 % të sipërfaqes së dyshemesë nëse dritaret janë nga jugu dhe lidhen drejtpërdrejt me mjediset e jashtme.(Shënim: sipërfaqja e xhamit që sheh nga jugu është më e vogël pasi cilësia e dritës që vjen nga jugu është më e mirë.);
- 10% e sipërfaqes së dhomës nëse dritaret orientohen nga lindja apo perëndimi;
- 15% të sipërfaqes së dyshemesë së dhomës nëse dritaret shohin nga veriu;
- 20% e sipërfaqes së dhomës nëse dritaret nuk janë në një mur të jashtëm.

Sipërfaqet që nuk kanë nevojë për dritare janë tualetet, dhoma e konferencave, holli dhe depot.
Nuk lejohet vendosja e skarave metalike në dritare.
Dritaret e jashtme dhe dyert e jashtme me xham duhet te jene me kase me material PVC me ndarje termike ose kase alumini gjithashtu me ndarje termike.
Specifikimet teknike te dritareve duhet te jene te detajuara dhe te marrin parasysh te pakten pikat me poshte:
Koeficientin U - 1.2 (*Ë/m²K*)
Ndarjen Termike –
Qendrueshmerine ndaj faktoreve atmosferike –
Aftesine ze-izoluese – (klasi 4)
Veshja me xham duhet të provojë nje vlerë të lartë të izolimit ndaj rrezeve të diellit (g). Kjo vlerë specifikon sa i lartë është rrezatimi diellor, i cili depërton nëpërmjet xhamit dhe ndihmon kështu në ngrohjen e ndërtesës.Tek xhamat e sotëm të dritareve të termoziluara kjo vlerë këshillohet rreth g = 60%.
Për të shmangur urat termike, duhet që dritarja të montohet nën nivelin e termoizolimit ose të paktën të montohet në këndin e jashtëm të murit. Izolimi kështu vendoset mbi kornizën e dritares. Duhet të kihet patjetër kujdes që gjatë momentit të montimit të realizohet një bashkim hermetikisht i vazhdueshëm i dritares. Montimi me ndihmën e shkumës nuk është i mjaftueshëm, meqenëse ajo në fazën e tharjes mblidhet dhe kështu nuk garanton më një izolim hermetik.

86.4.10 4.3.9 Kontrolli pasiv i temperaturës

Kontrolli mbi depërtimin dhe krijimin e nxehtësisë mund të minimizohet në mënyrë të natyrshme duke projektuar si duhet muret dhe suvatimine ndërtesës. Burimi i nxehtësisë është diellі, ndaj përjashtimi i dritës së drejtpërdrejtë të diellit nga ana e brendshme e ndërtesës është esenciale. Siç përmendet më lart, muret e jashtme mund të anashkalohen si burim i rëndësishëm i krijimit të nxehtësisë së brendshme gjatë ditës në shkollë. Kjo do të thotë se dritaret janë elemente që kërkojnë vëmendje. Kjo arrihet në dy mënyra:me orientim dhe reflektim të diellit.Duhet të theksohet se mjetet për krijimin e hijeve nga dielli brenda xhamit nuk janë të efektshme meqënëse materiali ngrohet dhe krijohen reflektime në brendësi. Është thelbësore që të ndalohet goditja e diellit në xham, nxehtësia nuk reflektohet jashtë përmes xhamit, meqënëse gjatësia valore ndryshohet dhe ambienti ngrohet. Duhet të theksohet se përdorimi i lustrimit të dyfishtë është i paefektshëm për ndalimin e depërtimit të diellit, kjo është efektive në parandalimin e humbjes së jashtme të nxehtësisë.

Orientimi për diellëzimin: drejtimi, ose orientimi më i mirë për të pasur dritë natyrale gjatë ditës në dritare është veri-jug (shiko figurën më poshtë): Orientimi nga Veriu në Shqipëri nuk reflekton drejtpërdrejt dritë të diellit në krahun e dritares, ndërsa orientimi nga Jugu reflekton rreze minimale, në dritare nën këndin më të vogël dhe të ngushtë gjatë ditës: në pjesën më të nxehtë të ditës, dielli do të jenë në zenit dhe këndi i rrezatimit të dritareve drejt jugut do të jetë më i ngushti.



*Orientimi i rekomanduar i shkoll*ës

- **Ajrosja (ventilimi i tërthortë)** do të jetë një faktor natyror i komfortit për pjesën më të nxehtë të vitit (shiko figurën më poshtë) por në pikat më të larta mund të ketë më shumë nevojë për të nxjerrë jashtë ajrin që është ngrohur duke kaluar nëpër tokë të ngrohtë e të thatë. Sidoqoftë, ndërtesat me hapësira me opsion të hapjes në të dy anët, nuk janë ekonomike, ndonëse kjo mënyrë rekomandohet si më optimale. Shkolla, si çdo grup ndërtimi tjetër, do të ketë një pjerrësi të shtypjes në kushte dhe drejtime të

ndryshme të erës, në mënyrë që ajri të qarkullojë nëpër ndërtesë nga shtypja pozitive dhe negative, deri në atë masë që mundësohet nga ndarjet dhe hapësirat e brendshme. Në këtë mënyrë bëhet freskimi i mundshëm gjatë natës, e që të ndihmohet nga dritat e jashtme që futen nga dritaret e jashtme të nivelit të sipërm.



Komodoteti Termik / Ventilimi i tërthortë

- **Reflektimi i diellit**: pajisje efektive për reflektimin e diellit mund të projektohen për të funksionuar në çdo orientim, meqënëse këndi i diellit është plotësisht i parashikueshëm. Megjithatë, për shkak të ndryshimit sezonal në lartësi, përjashtimi i rrezeve të diellit gjatë vitit do të kërkojë elemente të lëvizshme. Në praktikë, reflektimi është zakonisht një kompromis, edhe në qoftë se është projektuar orientimi optimal, reflektimi pas realizimit do të jetë efektiv. Duke supozuar orientimin nga jugu, dritarja do të reflektohet nga një raft i jashtëm horizontal në nivel të majës së dritares, me projektim që varet nga kohëzgjatja e vitit që dëshirohet për tëi parandaluar rrezet e diellit që të hyjnë në sallë apo që të bien në dritare. Gjatë dimrit, do të ketë përfitime nga rënia e diellit, kështu që këndi i rënies së diellit që duhet të përjashtohet është ai prej majit deri në tetor. Ka rëndësi thelbësore evitimi i rënies së rrezeve të diellit në dritare pasi nxehtësia është shumë e efektshme kur mjedisi dhe vetë xhami nxehet, duke e rritur kështu efektin e ngrohjes. Duhet të theksohet se përdorimi i xhamave të dyfishtë është i paefektshëm në ndalimin e diellit, dhe është efektiv vetëm në parandalimin e humbjes së diellit nga jashtë. Ndërtimi i një kulmi të madh të dalë jashtë apo masa e dritareve me grila janë pjesë e zgjidhjeve të zakonshme të mbrojtjes ndaj diellit (shih figurën më poshtë), por ne projekt mund te parashikohen edhe masa te tjera qe bejne te mundur uljen e rrezatimit ne dritare, te tilla si brisolete, tendat e jashtme etj. Zgjidhja e propozuar duhet te jete e tille qe te mos pengoje hyrjen e drites por vetem rrezatimin direkt ne xham (jo grila).



Komoditeti termik / Mbrojtja nga dielli

86.5 4.4 Komoditeti Vizual

Përkufizimet dhe terminologjia
Nevoja për standarde të larta dhe një ndriçim i projektuar mirë për ndërtesat e shkollave bazohet në:

- **ndriçimin natyror** që rezulton nga drita e diellit e drejtpërdrejtë apo ajo e reflektuar nga toka dhe sipërfaqet e tjera të jashtme apo ato të brendshme;
- **ndriçimin artificial** nga burimet e rrymës elektrike (llambat, tubat fluoreshentë);
- **shkëlqimin** apo intensitetin e dritës qoftë nga burimi natyror apo ai artificial apo nga ndonjë sipërfaqe ose objekt i padepërtueshëm që nuk është transparent;
- **kontrastin** e shkëlqimit apo ngjyrës.

Faktorët mesatarë për reflektimin e dritës

Materialet	**%**
Allçi	85
Letra e bardhë	84
Lyerja e bardhë	75
Çimentoja	55
Gurë gri	50
Lënda natyrore e drurit (ngjyrë e lehtë)	33
Tullat e kuqe	20

Ndriçimit duhet tui kushtohet shumë rëndësi për çdo zonë veprimtarie pasi është element kyç për të krijuar një ambient sa më të ngrohtë.
Cilësia e dritës duhet tui krijojë ndjesinë pozitive nxënësve.
Ndriçimi i madh është më i përshtatshëm për hapësira ku kryhen veprimtari motorike; ndërsa ndriçimi me fokus mbi një detyrë specifike nevojitet për veprimtari manipulative; ndriçimi më i dobët duhet për zonat e qeta .
Sasia dhe orientimi i dritës natyrale duhet të merret parasysh në projektimin dhe variacionin në nivelin e dritës.
Në dhomat me ndriçim të varfër natyral lejohet një maksimum prej 500 lx.
Dhomat që nuk kanë dritare në tavan apo dritare të jashtme, duhet të pajisen me tuba përcjellës së dritës natyrale.
Hapësira dritash të cilat e tejçojnë më thellë dritën në brendësi mund të përdoren në tërë faqet nga jugu. Projektuesit mund tëi referohen tabelës për vlerat minimale të dritës për funksione të ndryshme.
Për më tepër duhet të mbahet parasysh sa vijon: Me dritën e pasqyruar, fëmijët nuk do të shohin në mënyrë të drejtpërdrejtë burimin e dritës, një kusht ky që shkakton shkëlqim verbues dhe lodhje të syrit. Dritat me fokus si ato të varurat të tipit rezidencial, duhet të përdoren kur lexohet, pikturohet dhe bëhet punë e imët.
Projektimi i shumëllojshmërisë në ndriçim me mjete si kontroll të nivelit të dritës, çelës të veçantë, kabllo me orientim të rregullueshëm dhe kabllo të varur duhet të vendosen në zonën e punës. Mund të provohet të vendoset ndriçim specifik për të paraqitur vepra të ndryshme arti, abazhurë me shumë llamba për të krijuar një

atmosferë të gëzueshme dhe nivele të larta dritash për të nxitur veprimtarinë fizike.

Drita e jashtme duhet të kontrollohet nëpërmjet kondraperdeve apo llojeve të tjera të mbulimit të dritareve. Këto masa duhet të mundësojnë shikueshmëri të qartë. Ndriçimi i jashtëm duhet të jetë i mjaftueshëm që të mundësojë qarkullim dhe siguri. Të gjitha llambat duhet të kenë lente apo mbulesa për tui bërë rezistente nga thyerja.

Lux i këshillueshëm nëe hapësirat e shkollës

HAPËSIRA	**NDRIÇIMI**	**NDRIÇIM NË LUX**
Klasat	Ndriçim natyral	300
Klasat (pranë dërrasës se zeze)	Ndriçim natyral	500
Laboratorë	Ndriçim natyral	400 - 500
Punëtori	Ndriçim natyral	400 - 500
Dhoma e muzikës / vizatimit	Ndriçim natyral	400 - 500
Zona e magazinimit		300 - 500
Biblioteka		300 - 500
Hapësira shumëpërdorimshe		300 – 400
Salla e edukimit fizik	Ndriçim natyral	300 – 400
Zyra e drejtuesit/nendrejtorit	Ndriçim natyral	500
Sekretariati	Ndriçim natyral	250 - 350
Salla e mësuesve	Ndriçim natyral	500
Salla e personelit ndihmës	Ndriçim natyral	250 - 350
Tualeti		150 – 250
Kabineti i mjekut	Ndriçim natyral	500
Kabineti i psikologut	Ndriçim natyral	500
Depo		250 – 350
Holli	Ndriçim natyral	300 – 400
Shkallët	Ndriçim natyral	304 – 400

86.6 **4.5 Komoditeti Akustik**

Në ndërtesat e shkollave një vëmendje të veçantë duhet tui kushtohet izolimit akustik. Në nivel urban pozicionimi i shkollës, siç është trajtuar më lart, duhet të jetë në zona të qeta larg akseve të rëndësishme rrugore. Preferohet që pozicionimi i tyre të bëhet në brendësi të zonës së banimit.
Në raste kur kjo gjë nuk është e mundur atëherë zgjidhjet janë të ndryshme, qoftë me barriera fizike si mure, qoftë me barriera fizike të gjelbërta si bimësi të lartë.
Në brendësi të shkollës strukturat duhet të garantojnë një izolim akustik të specifikuar sipas tabelës së mëposhtme:

Elemente konstruktive	**Kërkesat e Rë në dB**

Mure ndërmjet ambienteve të klasave dhe ambienteve të ngjashme	47
Mure ndërmjet ambienteve të klasave dhe korridoreve	47
Mure ndërmjet ambienteve të klasave ose ambienteve të ngjashme dhe shkallëve të ndërtesës	52
Mure ndërmjet ambienteve të klasave ose ambienteve të ngjashme dhe ambienteve “veçanërisht të zhurmshme” (p.sh. Mjediset e administratës)	55

Është e këshillueshme që gjatë projektimit të impianteve dhe të strukturave të tjera të merren parasysh këto rekomandime:

- Të gjitha tubacionet (ajrit të kondicionuar, furnizimit hidrik) që përshkojnë muret që tejçojnë zhurma duhet të vishen me material për mbrojtje akustike;
- Në mjediset ku mendohet se mund të krijohen nivele akustike të larta të vendosen elemente të mobilimit të tilla që të ndihmojnë në uljen e niveleve akustike si p.sh. në korridorre të vendosen linoleum, tapet etj;
- aty ku mundet suvatimi të jetë me materiale që zbusin nivelin akustik;
- për të ulur nivelet akustike, gjatë projektimit të mendohet të përdoren materiale për të zbutur zhurmat brenda kopshtis;
- xhamat e dyerve dhe dritareve duhet të jenë qelq i laminuar akustikisht me nj aftësi izolimi akustik 35dB, me hapësirë ajri nga 50mm deri në 100 mm;
- dyert që hapen nga zonat e zhurmshme duhet të sigurojnë një izolim të lartë akustik
- këshillohet të përdoren materiale tekstile për të ulur nivelin akustik;
- për të izoluar sa më mirë zonën e dhomave me pjesën e jashtme apo me pjesën e administratës mund të përdoren edhe dopio dyer ose sistemi tambur. E njëjta gjë këshillohet edhe për dritaret në zgjidhjen e dritareve dopio. Kjo zgjidhje ndihmon edhe për të arritur një izolim më të mirë termik duke pasur parasysh që dyert dhe dritaret janë dhe zonat më delikate në kuptimin akustik edhe termik;
- kutitë e prizave elektrike nuk duhet të instalohen me kurriz.

Arritja e mbrojtjes nga zhurma brenda një objekti nuk varet vetëm nga masa e transmetimit të zërit në elemente konstruktive e ndarës, por gjithashtu edhe nga masa e zëizolimit gjatësor i elementeve konstruktive të anashkruara. Megjithatë kjo lidhje në praktikë shpesh lihet jashtë vëmendjes. Kush mjaftohet me zëizolimin në një objekt vetëm nga vlera të veçanta të elementeve konstruktive ndarëse vjen në një rezultat jo të mjaftueshëm, pasi zëizolimi gjatësor i elementeve kontruktive të anashkruara përcakton kufirin e performancës në zëizolim. Vetëm një pikë e dobët në izolimin e elementeve të anashkruar (p.sh.

pllaka të pandërprera të shtresës së dyshemesë, elemente të lehta të fasadës, mure prej tullave me vrima) e zvogëlojnë masën e rezultuar të zëizolimit, sa që ndryshimet në masën e zëizolimit të elementeve kontruktive ndarëse e bëjnë të parëndësishme.
Planifikimi me përgjegjësi fillon së pari me arritjen e qartësimit të masës zëizoluese të elementeve konstruktive të anashkruara dhe në këtë fushë të arrihen kushtet e nevojshme për rezultate pozitive të zëizolimit gjatësor në ndërtesë. Më pas duhen të zgjidhen mure ndarëse në përshtatje me rrethanat.

86.7 4.6 Ngjyrat dhe përdorimi i tyre

86.7.1 4.6.1 Kuptimi i ngjyrave

Ngjyrat ndikojnë te nxënësit në mënyra të ndryshme duke i bërë të ndihen të lumtur, të mërzitur, të qetë ose meditativë. Ngjyrat ndikojnë në perceptimin e madhësisë së ambientit, komoditetit etj.
Ngjyra mund të ndryshojë perceptimin tonë për dimensionet dhe distancën. Një mur i lyer në nuancë më të errët apo ngjyrë më të ngrohtë do ta afrojë atë duke e bërë të duket më afër se çëështë në të vërtetë. Kjo vjen në ndihmë kur lyhen muret në fund të korridoreve të ngushta.
Në rastet e një ambienti të vogël duhet të përdoren ngjyra të hapura dhe me tonalitete të ftohta.
Për këtë arsye përdorimi i tyre në shkolla është i domosdoshëm, por duhet edhe të kihen parasysh ndikimet e tyre te fëmijët.

- ***E kuqja*** lidhet me diellin dhe mund të shtojë rrahjet e zemrës. Është një ngjyrë mjaft stimuluese dhe simbolizon veprimtaritë dhe dëshirën për jetën, si dhe ngrohtësi.
- ***Portokallia*** është një version më pak i fortë se e kuqja . Krahasohet me gëzimin që ngjall e verdha. Jep gëzim dhe ndihmon në kapërcimin e traumave. Përfaqëson natyrën me diell dhe të bukur.
- ***Bluja*** në terapinë e ngjyrave njihet si ngjyra e tranzicionit, Bluja ofron përkrahje dhe mbrojtje dhe është ngjyra e paqes, qetësisë dhe zgjuarsisë.
- ***Roza*** si bluja ka efekt qetësues dhe sugjeron ngrohtësi dhe qetësim.
- ***E gjelbra*** është ngjyra e rinisë, rritjes, shpresës, gëzimit, jetës dhe freskisë. Është gjithashtu ngjyra e harmonisë dhe ekuilibrit.
- ***E verdha*** është një ngjyrë optimizmi dhe është efikase si një ngjyrë stimuluese diellore. Sjell qartësi

Nxënësit, në veçanti, kanë nevojë për një ambient dinamik dhe stimulues për të rritur dhe formuar intelektin e tyre.
Dhomat me ngjyrë portokalli, jeshile ose bojëqielli i shoqërojnë në një dimension didaktik, stimulojnë aktivitet e tyre sensoriale dhe i qetësojnë ata.
Në teorinë e përgjithshme të ngjyrave ndarja e parë bëhet midis tonaliteteve të ngrohta dhe atyre të ftohta.
Në tonalitetet e ngrohta kategorizohet ngjyra e verdhë, e kuqe, portokallia dhe të gjithë tonalitetet e ndërmjetme. Këto janë ngjyra aktive, pozitive dhe lidhen me

aksionin, me tingujt e lartë dhe me lëvizjen e vazhduar. Nga një eksperiment është vënë re se zemra rreh më shpejt në një dhomë me ngjyrë të kuqe se nënjë me ngjyrë bojëqielli.
Tonalitetet e ftohta janë bojëqielli, blu, e purpurt, të cilat janë ngjyra të qeta, pasive që stimulojnë meditim dhe qetësi.

- Në hapësirat që kanë funksion loje dhe punë aktive, janë të këshillueshme ngjyrat dhe tonalitetet e ngrohta midis të verdhës së lehtë, të verdhë në portokalli ose portokalli të hapur sepse stimulojnë prodhimin e adrenalinës, dhe për rrjedhojë ndikojnë në krijmtarinë dhe në kapacitetet motorike.
- Në zonat e qeta preferohen ngjyrat dhe tonalitetet e ftohta, sepse në pikëpamjen fiziologjike, një mjedis me tonalitete jeshile-blu-bojëqielli, ndikojnë në uljen e rrahjeve kardiake duke sjellë ndjesi qetësie.

86.7.2 4.6.2 Përdorimi i ngjyrave

Para se të mendohet për ngjyrat specifike, është e rëndësishme të përcaktohet se sa dritë natyrale ka ambienti. Të identifikohen zonat e vogla dhe të vështira. Të përcaktohet funksioni që kanë dhomat dhe klasat, më pas të përcaktohet atmosfera që dëshirohet të krijohet, pra nëse duhet e ftohtë dhe harmonike apo e ngrohtë, mikpritëse apo e rehatshme.
Ngjyrat duhet të zgjidhen me kujdes për të krijuar ekuilibrin emocional.
Veprimtaritë që ndodhin në zona të ndryshme do të kërkojnë skema të ndryshme ngjyrash dhe duke e mbajtur skemën kryesore të ngjyrave të butë, mund të përdoren ngjyra më të forta e më të ndezura në zona si dyer, dritare, cepat dhe kornizat. Si zgjidhje për të mbajtur ekuilibrin, një nga rrugët më të thjeshta e më të suksesshme është përdorimi i dy, tre apo më shumë ngjyrave që qëndrojnë pranë e pranë në prizmin e ngjyrave, si: pjeshka, kajsia dhe portokallia, apo e gjelbra, e gjelbër në blu, akuamarina dhe e kaltra.
Përdorimi i këtyre skemave quhet përzierje apo harmoni, sepse të gjitha ngjyrat janë të kombinuara, të balancuara duke mos përplasur dy ngjyra.
Nëse kërkohet një atmosferë e qetë dhe e freskët atëherë duhet të zgjidhen ngjyra të gjelbra, si blu në të gjelbër apo blu të gjelbra. Nëse atmosfera duhet e ngrohtë atëherë kjo arrihet me anë të ngjyrës së kuqe, rozë, portokalli dhe të verdhë.

19. IMPJANISTIKA

Te Pergjithshme

Projektet e impiantistikes do ti referohen kushteve teknike te projektimit dhe te standardeve te Republikës se Shqipërisë (K.T.P - STASH) dhe për elementet te veçante që nuk janë parashikuar në këto norma, do ti referohet euronormave (EN) dhe eurostandart (EN,HD) si dhe rekomandimeve të CEI, CENELC, DIN, VDI/VDE, ose normave lokale dhe standardeve te Komunitetit Evropian.
Projektet e impiantistikes permbajne:

- Projekti i plotë i ngrohjes dhe ventilimit shoqeruar me detajet perkatese, listen e materialeve dhe specifikimet teknike te materialeve.
- Projekti i plotë i rrjetit elektrik (perfshire sistemin telefonik dhe kompjuterik) i shoqëruar me detajet përkatëse dhe tabelen e materialeve dhe specifikimet teknike te materialeve
- Projekti i plotë i ujësjellësit i shoqëruar me detajet përkatëse dhe tabelen e materialeve dhe specifikimet teknike te materialeve
- Projekti i plotë i kanalizimeve i shoqëruar me detajet përkatëse dhe tabelen e materialeve dhe specifikimet teknike te materialeve
- Projekti i plotë i mbrojtjes kundra zjarrit i shoqëruar me detajet përkatëse dhe tabelen e materialeve dhe specifikimet teknike te materialeve.
- Specifikimet përfundimtare të materialeve dhe pajisjeve.
- Grafiku i plotë i punimeve.
- Metodologjia e zbatimit të punimeve duke specifikuar mënyrën e ruajtjes së ambientit të ndërtimit nga ndotja. (projekt mjedisor)
- Preventivi i detajuar i kostos së ndërtimit në buxhetin e rënë dakort midis palëve për çdo objekt i kushtëzuar nga zona gjeografike ku ndërtohet. Për zërat kryesorë do të paraqiten analizat përkatëse të ndërtimit.

86.8 Projekti i plotë i ngrohjes dhe ventilimit

86.8.1 Të dhënat meteorologjike dhe kushtet e jashtme të mjedisit.

Gjatë fazës fillestare të projektimit të impianteve mekanike duhet të merren në konsideratë pozicioni gjeografik i objektit cili kushtëzon mënyrën e projektimit për shkak të kushteve të jashtme meteorologjike që zona ka si dhe faktorët e brendshëm që ndikojë në temperaturën e ambientit si, ndricimi, pajsijet që emetojne nxehtësi etj.Ndër faktorët e shumtë që influencojnë mbi komfortin termik në ndërtesa mund të përmenden:

- Temperatura
- Lagështia e ajrit
- Rrezatimi diellor
- Erërat

Në tabelën e mëposhtëme jepen temperaturat e jashtme projektuese për periudhën e dimrit dhe të dhënave gjoegrafike sipas qyteteve për Republikën e Shqipërisë

Tabela Nr.5.Tabela e temperaturave të jashtme projektuese

	Nr.	Qyteti	Lart. Mbi nivelin e detit (m)	Gjeresia gjeografike (grad,min)	tllog
	35	Tiranë	110	41 20	-1.0

* N. k.to qytete seria klimatologjike është më e vogël se 30 vjecare

86.8.2 Normat projektuese dhe vlerat e rekomanduara të temperaturave të ambienteve

Kushtet termike brenda ndërtesave arsimore duhet të jenë të përshtatshme per aktivitetin qe kryhet ne to. Èshtë e nevojshme që projektuesi të marrë në konsideratë funksionin e mjediseve dhe aktivitetin që kryhet.Në tabelën e mëposhtme jepen vlerat e rekomanduara të temperaturës së brendshme, lageshtisë relative, sasisë së ajrit të freskët, nivelit të zhurmës dhe shpejtësisë së lëvizjes së ajrit që duhen patur parasysh gjatë fazës së projektit të ambienteve shkollore.

Tabela Nr.2. Tabela e vlerave rekomanduese të parametrave klimatik të brendshëm.

Destinacioni i Ambientit	Dimer	Vere	Lageshtia	Sasia e ajrit të freskët	Volumet e ajrit për orë	Niveli i zhurmës	Shpejtesia e ajrit m/s
Klasa	22	26	35-60%	8 (L/s*person)	6	35-40 dB(A)	0.15
Auditorë	22	26	35-60%	8-10 (L/s*person)	12	30-35 dB(A)	0.15
Laboratorë	22	26	-	10 (L/s*person)	10	40 dB(A)	0.13-0.15
Salla leximi	20	25	55% +/-5%	8 (L/s*person)	-	45 dB(A)	0.07-0.15
Zyra	22	26	55% +/-10%	8 (L/s*person)	6	45 dB(A)	0.07-0.15
Biblioteka	22	26	45-50%	8 (L/s*person)	-	40 dB(A)	0.13
Dhoma Zhveshje	24	-	-	2.5 (L/s*m2)	10	55 dB(A)	0.15
Korridore, shkallë	20	27	-	0.5 (L/s*m2)	4	50 dB(A)	0.15
Magazina	18	-	-	-	4	55 dB(A)	0.15
Ambiente teknike	16	-	-	-	-	55 dB(A)	0.15
Menca, bare	21-23	23-26	20-30% / 55-60%	10 (L/s*person)	12	50 dB(A)	0.13-0.15
Palestra	20-22	25-26	30-70%	8 (L/s*person)	6	45 dB(A)	0.12-0.15
Pishina	26	30	50-60%	-	4-6	45 dB(A)	0.13
Konvikte	20	25	50%	15 l/s/ dhome	4	30 dB(A)	0.15
Nyje sanitare, dushe	24	-	-	2.5 (L/s*m2)	6-10	55 dB(A)	0.15
Sherbime, dyqane	22	26	50%	1-1.5 (L/s*m2)	-	47-56 dB(A)	0.015-0.2
Muze	20	25	55% +/-5%	10 (L/s*person)	-	40-50 dB(A)	0.13
Kuzhina gatimi	20-23	28-30	-	508-762 l/s/m2	12	55 dB(A)	0.15-0.25

Impiantet mekanike janë mjaft të rëndësishme për funksionimin e një godinë dhe zhvillimin normal të aktivitetit për të cilën destinohet të shfrytëzohet nga përdoruesit.

Pavarësisht funksionit dhe përdorimit të godinave, impiantet mekanike duhet të plotësojnë kriteret bazë të domosdoshme përkundrejt projektimit, zbatimit të punimeve në objekt dhe shfrytëzimin nga përdoruesit të cilat janë:

- Përshtatshmëri dhe komfort në përdorim,
- Besueshmëri në funksionin e tyre,
- Kontroll të plotë teknik,
- Të garantojë kushtet higjenike dhe siguri teknike,
- Të mundësojë përdorim parcial të adresuar,
- Të garantojë kursim të energjisë së përdorur,
- Të respektojë kushtet ambientale,
- Të garantojë kosto të ulëta mirëmbajtje,
- Të ndërtohet me komponentë standard.

Projektet, punimet e zbatimit dhe shfrytëzimit nga përdoruesit mbështeten në kuadrin ligjor dhe V.K.M-të e Republikës së Shqipërisë dhe në rastet kur ky kuadër nuk parashikon terma ose argumenta të veçantë, ato mbështeten në standarted, norma dhe udhëzime kryesisht italiane (UNI,UNIEN) dhe europiane (ISO, EN).

Sistemi i ngrohjes do te jete me kaldaje me pelet, me radiatore panel te cilet do te jene te pajisur me valvola termostatike. Rrjeti i dergimit dhe kthimit te ujit duhet te jete:

- Per tubacione me diameteter me te vogel ose te barabarte me 28 mm, me material Pex-Al-Pex ose baker me veshje termoizoluese sipas standartit
- Per tubacione me diameter me te madh se 28 mm mund te jete me tuba celiku te zi pa tegel ose me ndonje material tjeter, i termoizoluar sipas standartit te nevojshem per dimensionet e tubit
- Për palestra mund të aplikohet sistemet e ngrohjes në dysheme ose impiante ngrohje me ajër të ngrohtë(tipi i aerotermave).
- Pompat qarkulluese duhet te jene te tipit inverter
- Projektuesi bashke me projektin duhet te paraqese dhe llogaritjen e humbjeve termike

Sistemi i ngrohjes me pelet duhet projektuar i tille qe te permbushi te pakten kushtet me poshte:

- Te kete nje depozite peleti me autonimi te konsiderueshme (deri ne dy-mujore bazuar ne llogaritjet termike te objektit)
- Depoja ose depozita e peletit duhet te jete prjektuar ne menyre te tille qe te garantohet mbushja pa nevoje per fuqi puntore shtese direkt nga makinat veshkarkuese standarte
- Depoja ose depozita e peletit duhet te garantoje mbrojtjen e peletit nga faktoret atmosferike
- Sistemi duhet te jete automatik, i pajisur me mekanizmat perkates te transportit te peletit nga depoja e pelletit, ne depoziten e ndermjetme (nese do jete e nevojshme, dhe ne kaldaje) pa pasur nevoje per fuqi punetore shtese
- Depozita e peletit, depozita ose sillosi i ndemjetem si dhe kaldaja duhet te vendosen ne ambjente duke respektuar te gjitha normat e nevojshme per

mbrojtjen nga zjarri, ventilimin, hapesirat e nevojshme te punimeve te mirembjatjes dhe riparimit etj.

- Kaldaja mund te jete monoblock ose disa kaldaja me pelet te vendosura ne menyre te tille qe te plotesojne fuqine termike te kerkuar. Ne cdo rast, rendimenti is eciles kaldaje duhet te jete te pakten 89% llogaritur sipas normes BS 845-2:1987 ose ndonje norme ekuivalente
- Duhet te merret ne konsiderate shkarkimi i lehte i mbetjeve te hirit nga djegja dhe largimi i mbetjeve ne vende te percaktuara si vend depozitimi i pershtatshem.

Ventilimi

Duke qënë se në ambientet shkollore kemi të bëjmë me zona me densistet të lartë të popullimit dhe duke marrë parasysh që sistemi imunitar i nxenësve që do të frekuentojnë këto ambiente është relativisht i dobët, sistemi i ventilimi të ambienteve bëhet shumë i rëndësishëm dhe kërkon një kujdes të vecantë në llogaritjen dhe zgjedhjen e tipologjisë që do të përdoret sipas rastit.
Sistemi i Ventilimit të ambienteve shkollore duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të arrijë të plotësojë qellimet kryesore të aplikimit të tij si:

q. *Duhet të arrijë të plotësojë kërkesën për ventilim dhe furnizim me ajër të freskët për nevoja ëe frymëmarrjes të personave që do përdorin këto ambiente*
r. *Duhet të siguroj largimin e ndotësve dhe aromat e këqija nga ambientet duke bërë të mundur përmirësimin e cilësisë së ajrit.*
s. *Mundësisht të rregullojë përqëndrimin e lagështisë të ajrit në ambiente.*
t. *Përmirësimin e komfortit termik duke ruajtur regjimin termik të impianteve të ngrohjes/ftohjes.*

Vlerat e shkëmbimit të ajrtit të ambientit e shkollave dhe shkollave është ne varësi të destinacionit të përdorimit të ambientit.
Ne ***tabelen nr 2*** jepen vlerat e rekomanduara të sasisë së ajrit të ndërruar sipas destinacionit të përdorimit të ambientit.
Te gjitha klasat, palestra, biblioteka, laboratore dhe ambjente te tjera me perdorim masiv duhet te kene sisteme ventilimi mekanik me rikuperim nxehtesie (te pakten 60%) dhe duhet te jene te pajisur me filter minimalisht te klasit F7. Tubacionet e ajrit dhe grilat duhet te jene te dimensionuara ne menyre te tille qe te garantohet shperndarje e mire e ajrit dhe niveli i zhurmave te jete brenda normave te lejuara per secilin ambjent. Tubacionet e ajrit duhet te jene te termozoluara.
Sistemi i ventilimit duhet te projektohet ne mnyre te tille qe ne rast zjarri te fiken automatikisht, dhe nese do te projektohen si njesi qendrore (qe i sherbejne me shume sesa nje ambjenti), te parashikohen damferat e zjarrit

Ventilimi i nyjeve sanitare

Në ventilimin e nyjeve sanitare duhet të respektohen:

- Shpejtësia e ajrit nuk duhet ti kalojë 6m/s.
- Tubacionet fleksible nuk duhet të kalojnë 3000 mm gjatësi.
- Pikat e thithjes së ajrit duhet të pozicionohen mbi cdo ambient të mbullur.

86.8.3 Centrali termik

Gjatë fazës së projektit një vëmëndje të vecantë duhet ti kushtohet konceptimit dhe projektimit të drejtë të Centralit termik. Në mënyrë që Centralet termik të jenë mirëfunksional dhe me qellim që të shmangen sa më shumë problemet gjatë kohës së operimit të sistemit, duhen patur parasysh:

- Duhet të parashikohet një hapësirë të paktën prej 10% e sipërfaqes bruto të godinës për impiantet mekanike.
- Ambienti teknik duhet të kompletohet me shkallë ose me raste dhe parashikimi i mjeteve ngritëse per mirëmbajtjen e nevojshëme dhe pajisjet që mund të zëvendësohen.
- Dyert e ambientit teknik duhet të jenë minimalisht të përmasave 230x180. Dyert e jashtme duhen të jenë të hapëshme dhe të heqshme në mënyrë që në rastin kur ka zëvendësim të pajisjeve të mëdha të cilat nuk mund të vijnë në pjesë të ndara.
- Dhoma teknike nëntokësore duhet të pajisen me hapësira të posacme dhe me përmasa të tilla qe te lejojne zevendesimin e pajisjeve me te medha te ambientit teknik.
- Pikat e ajrosjes së ambientit teknik duhet të pozicionohet të paktën 50 cm mbi nivelin e tokës.
- Të gjitha daljet e linjave apo kanaleve duhet të shoqërohen me qafore për mbrojtje nga zjarri.
- Ambientet teknike nuk duhet të përdoren si zonë për marrjen dhe nxjerrjen e ajrit nga makineritë.
- Një tub kondensati duhet vendosur në cdo pjesë të pajisjeve që perdorin avull. Kondensa duhet të shkarkojë me vetrrjedhje të cilat më pas do të shkarkojnë në piletë ose në pompën e drenazhimi.
- Duhet të ketë hapësira të përshtatëshme për pasazhe rreth e qark pajisjeve të ambientit teknik për të lejuar mirëmbajtjen, të sjellë pajisjet e riparuara, pajisjet e përkohëshme, zëvendësimi i pajiseve të vjetra si dhe siguria nga tensioni i lartë.
- Duhet të ketë ndricim të mjaftueshëm në brendësi të ambientit teknik për të lehtësuar punën e personave të mirëmbajtjes.

86.9 Projekti i plotë i rrjetit elektrik

Projekti elektrike do të përmbajë këto sisteme:

41. Rrjeti I furnizimit me tension të mesëm TM.
42. Kabina elektrike e transformimit TM/TU.
    2.13. Struktura e ambjenteve
    2.14. Tipologjia e pajisjeve
    2.15. Skemat dhe llogaritjet e ngarkesave sipas kërkesave.
43. Sistemi I furnizimit me energji emergjent-Gjeneratorët
    43.1 Struktura e ambjenteve
    43.2 Tipologjia e pajisjeve
44. Sistemi I furnizimit me energji I sigurisë UPS.

45. Linjat kryesore të furnizimit me energji të Paneleve elektrike kryesor nga Kabina elektrike.
    - 45.1 Karakterisitikat funksionale të rrjetit të shpërndarjes kryesore
    - 45.2 Rrjeti dytesor i shpërndarjes
46. Kuadrot elektrike
    - 46.1 Kuadrot elektrike të katit, zones ….
    - 46.2 Rrjeti dytësor i shpërndarjes
    - 46.3 Kuadrot e ambjenteve të vecanta.
47. Rrjeti i përgjithshëm i fuqisë.
    - 47.1 Furnizimi i konsumatoreve të përgjithshëm nga rrjeti normal
    - 47.2 Furnizim i konsumatorëve preferenciale nga gjeneratori
    - 47.3 Furnizim i komsumatorëve të rëndësishëm nga UPS
48. Rrjeti i ndricimit
    - 48.1 Rrjeti i ndricimit normal të pergjithshëm
    - 48.2 Rrjeti i ndricimit të natës
    - 48.3 Rrjeti i ndricimit të jashtëm etj.
49. Rrjeti i ndricimit të sigurisë
    - 49.1 Rrjeti i ndricimit emergjent
    - 49.2 Rrjeti i ndricimit të evakuimit etj.
50. Rrjeti I tokëzimit, shkarkimeve atmosferike dhe skemave ekuipotenciale

Projekti e instalimeve speciale do të përmbajë këto sisteme:

9. Impiantet e sistemeve të sigurisë
    - 9.1 Impianti idedektimit dhe sinjalizimit të zjarrit dhe gazit
    - 9.2 Impianti I lajmerimit zanor
    - 9.3 Impianti kunder hyrjeve të padëshiruara
    - 9.4 Impianti I kontrollit të dyerve
    - 9.5 Impianti I monitorimit CCTV.

10. Impiantet e sistemeve të komunikimit
    - 10.1 Impianti i kabllove të strukturuar, fiber optike
    - 10.2 Pajisjet aktive të rrjetit të transmetimit të të dhënave
    - 10.3 Impianti i sinjalit televiziv, TV-SAT.
    - 10.4 Impianti videocitofonik

Sistemet e mësipërme do të jenë të shoqeruara me të gjithë llogaritjet, dhe specifikimet teknike të përzgjedhura.

- **Sistemi i furnizimit me energji elektrike.**

Ky sistem do të projektohet në mënyrë të tillë që të sigurojë furnizim të pandërprerë me energji elektrike të të gjitha ambienteve. Për këtë do te parashikohen 3 burime të furnizimit me energji elektrike.

m) Nga rrjeti elektrik energjitik i sistemit - Tension normal

Në varësi nga organizimi i ambjenteve do të bëhet dhe ndarja e linjave të furnizimit me energji elektrike. Psh sistemet e sigurisë do të kenë furnizim të pandërprerë nga UPS po kështu zonat me ndjeshmëri të lartë për fëmijët

gjithashtu me linjat e UPS do të furnizohen dhe sistemet informatike, ato të ruajtjes së informacioneve të pandërprera nëse ka etj.

n) Me tension kritik (nga gjeneratori pas 15-20 sek) do të furnizohen ato konsumatore të cilët për periudhën 15-20 sek nuk humbin parametrat e punës dhe nuk ndikojnë në zhvillimin normal të aktivitetit të kopshtit.

Me ketë tension do të furnizohen konsumatoret e ndricmit të përgjithshëm, ndricimit emergjent, sistemet e sigurisë etj.

o) Me tension normal do të furnizohen të gjitha ambjentet e kopshtit duke e quajtur si furnizim baze të tij por që për arsye sigurie dhe vazhdueshmerie do të dublohet me tensionet nga gjeneratori dhe UPS në mënyrë automatike të cilat duhet të parashikohen në skemat e projektimit.

Per furnizimin e objektit me energji elektrike në rastet kur fuqia e kerkuar kalon vlerën mbi 150 kË dhe nuk ka mundësi per lidhje të energjisë në tension të ulët në atë zonë do të parashikohet ndërtimi i një kabine elektrike, për të cilin do të parashikohen këto dhoma teknike :

- dhoma e tensionit te mesëm

Në këtë dhomë do të vendosen bokset e tensionit të mesëm sipas kësaj radhitjeje:

q. Boksi i hyrjes së tensionit të mesëm 20kv
r. Boksi i daljes së tensionit të mesëm 20kv
s. Boksi i matjes së tensionit të mesëm 20kv
t. Boksi i takim stakimit mbrojtes TR1

- Në dhomën e dytë të parashikohen vendosjet e transformatoreve të tensionit të mesëm TM 20/0.4 kv të cilët duhet të jenë të tipit me rezinë.

Transformatorët ndahen nga ambjenti me rrjetë hekuri me kanalinë 40x40x4 (mm) me dyer të siguruar dhe me elemente mbrojtes në rast të hapjes së dyerve.

- Në dhomën e tretë parashikohen të vendosen gjeneratorët të cilët pasi të bëhen kalkulimet do të percaktohet dhe fuqia e tyre.
- Në dhomën e katërt do të vendoset paneli i kalimit automatik rrjet gjenerator si dhe paneli i rregullimit te cos Φ i cili do të kalkulohet në bazë të fuqisë së instaluar dhe do të paraqiten llogaritjet etj

Kuadrot e tensionit të ulët është mirë që për efekt tensioni të paluhatshëm dhe kursimi të vendosen sa më afër ambjenteve që do të furnizojnë. Panelet e tensionit të mesëm dhe gjeneratorët do të parshikohen të vendosen jashtë objektit. Kuadrot e tensionit të ulët duke u vendosur brenda godines se kopshtit jane me te kontrollushem, te menaxhueshem dhe me ekonomik. Rekomandojmë që për projektin e instalimeve elektrike shtrirja e linjave të tensionit të ulët të bëhet duke respektuar sistemin TNS per tensionin tre fazor dhe duke respektuar sistemin TS për sistemin monofaze. Realizimi i projektit të paneleve të TU të bëhet konform normave CEI i programuar duke zbatuar fuqite dimensionet temperaturen , gjatesite e linjave dhe llojin e konsumatoreve. Gjatë hartimit të projektit duhet të kihet parasysh që linjat të jenë të drejtpërdrejta pa xhuntime te etiketuara sipas destinacionit dhe te dallueshme nga njera tjetra. dmth Rrjeti,Gjeneratori, UPS si dhe kutitë e derivacionit të etiketohen dhe të lexohen lehtësisht. Kuadrot elektrik duhet pasur parasysh gjatë projektit të kenë në mënyrë të padiskutueshme elementët matës mbrojtës kontrollues, mbrojtje nga shkarkimet atmosferike, etj. Kuadrot e tensionit duhet të sigurojnë qëndrueshmëri REI -120.

Projektuesi duhet të sigurojë Miratimin e projekteve elektrikë në ISHTI dhe CEZ si dhe të përcaktojë edhe pikën e lidhjes me energji elektrike, nga rrjeti i fuqisë (kabina ose transformatori i zonës).
Projekti elektrik të jetë i shoqëruar me liçensën e noteruar të inxhinierit elektrik, e cila do të shërbejë për procedurat e mëtejshme për miratimin e pikes së lidhjes me CEZ-in.

- **Sistemi i ndricimit**

Gjatë projektimit duhet patur parasysh që ky sistem do të përfshijë sa më qartë :

13. Skemat e ndricimit normal
14. Skemat e ndricimit emergjent
15. Skemat e ndricimit të evakuimit (Sinjalizimit)

Fluksi i ndricimit duhet të respektohet sipas ambjenteve ku do të instalohet duke respektuar Lux per m2 në ambjentet e qëndrimit, ngrënies, mësimit, korridoreve, kuzhinës, tualete etj.
Mënyra e komandimit të ndricimit të jetë e tilllë që të përdoret me efektivitet duke kursyer sa më shumë të jetë e mundur energjinë elektrike. Ndricmi i përdorur të jetë me llampa LED me eficense të lartë energjie dhe konsum minimal. Llampat LED duhet te specifikohen ne menyre te tille qe trupi ndricues (llampa) te jete e zevendesueshme pa pasur nevoje per te nderruar komplet ndricuesin ne rast defekti, te jete e afte te punoje per 50.000 ore pune dhe te plotesojne kerkesat e DIN EN 60598-1 (VDE 0711-1): 2005-03
Specifikimet teknike te ndricuesve duhet te konsiderojne te gjitha standartet e nevojshme qe gjate procesit te instalimit te shmanget mundesia e instalimit te produkteve te pacertifikuara.

- **Sistemi i fuqise nëpër ambjente**

Në të gjitha ambjentet të parashikohen priza monofaze që punojnë me tension normal dhe gjeneratori në përshtatje me mobilimin si dhe dalje ndricimi në banjo dhe aspiratori në rast nevoje.
Në korridore në distanca 15 -20 m të parshikohen priza monofaze me tension normal për pajisjet e pastrimit.

- **Skema ekuipotenciale**

Të ambjet të vecanta si ambjete teknike mekanike, elektrike, kuzhine, etj gjatë realizimit të projektit duhet patur parasysh të jenë të pajisura me një zbarë ekuipotenciale të vendosur pas cdo derë në të cilën do të jenë të lidhura të gjitha pjesët metalike në dysheme, mure apo tavane me skemën ekuipotencilale.
VO!
Realizimi i skemës ekuipotencile gjatë projektimit të jetë i ndarë në mënyrë absolute nga skema e tokëzimit dhe e rrufepritësit.
Brënda kutisë ekuipotenciale të parashikohet një zbarrë bakri me vrima për të realizuar të gjitha lidhjet e pikave ekuipotencile. Skema ekuipotencile fillon në cdo ambjent dhe perfundon në elektrodat e vendosura në tokë jashtë objektit.

- **Skema e tokëzimit**

Gjatë projektimit të skemës së tokezimit duhet të kihet parasysh që të studiohen mirë elementet si sigma e tokës, lloji i tokës, lageshtia e saj me qellim që gjatë kalkulimit rezistenca perfundimtare të jetë më e vogël ose e barabartë me 4 Ω.

Sasia e elektrodave varet nga realizimi i RT. Gjatë matjes me diferencial me rryma të komanduara nga 2mA-30mA releja diferenciale të veprojë brenda këtij diapazoni.

- **Sistemi i rrufepritësit**

Skema do të realizohet nga projektuesi duke patur parasysh që Rr të jetë më e vogël ose baraz me 10 Ω. konturi mbi sipërfaqen e tokës dhe në tarracë të realizohet me shirit zinku 30x3 dhe me shtiza zinku L=1.5m ndërsa konturi qarkues dhe lidhës i elektrodave ne tokën me përcjelles bakri të zhveshur S= 50mm2. Për cdo zbritje do të vendoset shkëputesi për matje. Numri i zbritjeve ti përmbahet relacionit n=P/15 +2 dhe rezistenca e rrufepritësit do të kalkulohet me vlerë më të vogël se 10 om.

- **Skema e furnizimit dhe kontrollit të pajisjeve mekanike dhe hidronike**

Gjatë realizimit të projektit të mbahen parasysh realizimi i skemave të kontrollit dhe furnizimit të elementeve të sistemit te ngrohjes, ventilimit dhe furnizim me ujë. Për këtë në funksion të skemave të përgatitur nga projektuesit mekanik dhe hidroteknik , projekti elektrik të parashikojë sa më poshtë:

25. panelin dhe kabllimin e njësive të ventilimit
26. panelin dhe kabllimin e pompave (ngrohje ftohje, binjake)
27. panelin dhe kabllimin e kaldajave
28. panelin dhe kabllimin e pompës së zjarrit
29. panelin dhe kabllimin e pompave të furnizimit me ujë
30. panelin dhe kabllimin e pompave zhytëse (nese do kete)

- **Sistemet e sigurisë**

Kamerat, alarmet dhe akses kontrolli do të vendosen në mënyrë të atillë që të sigurojnë në mënyrë të pandërprerë informacion ndërmjet ambjenteve si dhe vëzhgim të gjithë situatës në të gjithë ambjentet e kopshtit si brenda dhe jashtë. Për realizimin e projektit të instalimeve elektrike duhet të bëhet një bashkepunim dhe bashkërendim i punës në të gjithë grupet e projektimit me qëllim që ti shërbejnë sa më mirë të gjithë specialiteteve dhe të realizojmë një shërbim sa më cilësor të punës së personelit dhe aparaturave.

- **Sistemi i detektimit te zjarrit**

Gjatë realizimit të projektit për sistemin e detektimit të zjarrit duhet të kihen parasysh zgjedhja e detektorëve sipas funksionit që do të kryejnë dhe vendit ku do të montohen.
Gjatë kryerjes së projektit të kihen parasysh distancat e vendosjes së detektorëve, sirenave, pikave të thirrjes në mënyrë të atillë që të gjitha zonat të mbulohen duke mos lejuar zona të pambuluara. Në projekt të parashikohen detektorët multifunksional, optike , CO_2, NO_2, dhe detektorë temperature. Pikat e thirrjes të vendosen nëpër korridore në kuotat 1 m e 40 cm nga kuota 00 e katit. Sirenat e brëndshme dhe të jashtme të vendosen në pozicionet më të dëgjueshme dhe me akustikë më të mirë. Centrali që do të përdoret duhet të zgjidhet i tillë që të japi të gjitha informacionet e sistemit, vendodhjen e të gjithë elementeve të skemës dhe të jetë i pajisur me GSM. Centrali duhet të ketë akses tensioni 24 dhe 48 V për komandimin e damperave elektromagneteve etj.

Lupa e këtij centrali të mos kalojë 80-125 elementë duke përfshirë detektorë sirena etj. Centrali duhet të lidhet me sistemin e public adress te zonës pa shkatuar panik në zonat e tjera, Softi i sistemit të zjarrit të zgjidhet i tillë që të jetë i aksesueshëm në më shumë se dy pika dhe të japë në monitor një situatë të qartë të të gjithë sistemit.

- **Sistemi Tv satelitor dhe tokësor**

Ky sistem gjatë projektimit të ketë parasysh që të pajisjen të gjitha dhomave të argetimit dhe qëndrimit të fëmijëve, me sistem sinjali satelitor dhe tokësor.

- **Instalimi i njoftimit zanor**

Sistemi i njoftimit zanor do të përdoret për të dhënë informacion personelit në raste emergjente dhe në raste te vecanta. Teë gjithë komponentet si altoparlantet, centrali, komponentet shpërndarës dhe lidhës do të parashikohen dhe përshtaten për cdo ambjent. Ato mund të lidhen me pajisjen qendrore CD player për të vendosur muzikë në orare të përshtatshme.
Zonat/dhomat e mëposhtme do të pajisen për njoftimin zanor.
- Korridoret
- Ambjentet e përbashkëta

Gjatë fazës së projektimit, daljet e planifikuara duhet të koordinohen me ato të klientit.

- **Sistemi CCTV**

Në përputhje me kërkesat dhe standardet e instalimit projekti do të parashikoje një sistem CCTV për ambjentet e përbashketa të shkollave. Ai do të mbulojë fushat e nevojshme, të kërkuara nga përfituesit që janë të ndarë në kategori. Në bazë të këtyre kërkesave të veçanta të çdo fushë, do të jetë zgjedhja e pajisjeve që përmbush këto kërkesa. Për zonat jashtë do të jenë hyrjet kryesore, si dhe kërkesat e tjera që do të koordinohen me përfituesit, do të përdoret kamera të lëvizshme, të përshtatshme për instalimin, mbrojtjen anti-ndërhyrje, me IP-66 rast dhe me zbulimin lëvizje etj.
Për zonën e brendshme do të përdoret kamera me rezolucion të lartë, të vendosur në pikat kyçe të monitorimit. Të gjitha të dhënat e do të regjistrohen në pajisje regjistrimi NVR, i cili do të parashikohet në dhomën e serverit me kapacitet të llogaritur me kohën e kërkuar nga përfituesi. Në dhomën e monitorimit do të shfaqet imazhet e kamerave në monitori cili mbulon të gjithë hapesiren të ndarë në ekran në sa kamera jane parashikuar.

86.10
86.11
86.12 Projekti i plotë i ujësjellësit

Furnizimi me uji të ftohte sanitar është i domosdoshëm për zhvillimin normal të aktivitetit mësimor.
Furnizimi me uji i mjediseve arsimore mund të kryhet nga rrjeti urban ose prej puseve në rastet kur rrjeti urban nuk garanton nevojat për uji të këtyre ambienteve.

Gjithashtu krahës nevojës për kapacitet rezervë uji që do të shërbej për sistemin e mbrojtjes ndaj zjarrit duhet të sigurohet dhe sasia e nevojshme rezervë për nevoja konsumi në bazë të numurit të perdoruesve.
Vlerat referuese për prurjet e nevojshme për të gjitha pajisjet hidrosanitare që përdoren në mjediset e mësimdhenies jepen në tabelën e mëposhtme e shprehur në “l/s”.

PRURJET NOMIMALE QË DUHET TË SIGUROHEN NGA ÇDO RUBINET			
Pajisja hidrosanitare	Uji i ftohtë (l/s)	Uji i ngrohtë (l/s)	Presioni minimal mk H2O
Lavaman	0.10	0.10	10
Bide	0.10	0.10	10
Ëc	0.10		10
Pllakë dushi	0.15	0.10	10
Lavapjatë	0.20	0.20	10

Konsumi ditor minimal i nevojshme mbështetur dhe në Standardet Europiane që duhet të sigurohet për të plotësuar kërkesat për uji sanitar, është 25 litra/përdoures.

Furnizimi i ujit të ftohtë sanitar bëhet nëpërmjet rrjetit të jashtëm nga puseta e kontrollit. Pika e lidhjes duhet rakorduar me ndermarrjen e ujesjellesit. Sistemi i furnizimit me ujë nga rrjeti i jashtëm duhet të garantoje ujë të mjaftueshëm për përdorim sanitar. Nëpermjet prurjes dhe presionit që ka rrjeti i jashtëm bëhet furnizimi i rezervave të përgjithëshme të ujit. Një grup furnizimi me ujë duhet të përbëhet nga: matësi i ujit, reduktori i presionit, saraçineskat, valvula e moskthimit dhe filtëri “Y”. Grupi i pompimit duhet vendosur në ambientin teknik.
Rezervuarët e ujit duhet të llogariten dhe dimesionohen në mënyrë që të sigurojnë sasi uji për një autonomi të kërkuar (ndoshta 1 dite). Specifikimet (sasia, kapaciteti etj) duhet të përcaktohen nga projektuesi në bazë të diagramës së shfrytezimit ditor nga konsumatoret. Pervec rezervuareve te ujit te ftohte sanitar te vendosur ne ambjentin teknik, projekti duhet te permbaje dhe nje depozite uji me renie te lire si dhe lidhjen e tij me ËC-te dhe pisuaret per raste kur mund te kete mungese te energjise elektrike. Vellimi i depozites duhet llogaritur nga projektuesi dhe te kete autonomi te pakten 1 dite.
Cezmat ne nyjet sanitare duhet te jene te tipit me shtypje me kohe te caktuar per te beret e mundur kursimin e ujit, dhe gjithashtu te gjithe mishelatoret e ujit te ngrohte te jene me valvola termostatike

Centrali i pompimit është pjesa më rendësishme e sistemit. Parametrat e pompave duhet të llogariten në përputhje me diagramat ditore të nevojave për ujë dhe konfiguracionit të rrjetit.
Në funksion të tyre duhet llogaritur presioni, prurja, fuqia e pompave si dhe specifikime teknike të tjera. Sistemi duhet projektuar duke parashikuar një stacion pompimi, i cili instalohet në përputhje me kërkesat e projektit.
Rrjeti i shpërndarjes vjen nga stacioni i pompimit në godinën teknike për në nyjet sanitare. Çdo degëzim nga magjistrali kryesor shërben si degë furnizimi ose si

kolonë për një sektorë të caktuar duhet të jetë e pajisur me një valvul ndërprerëse, për të ndërprerë prurjen e ujit në rastet kur kërkohet të ndërhyhet në sistem pa ndërprerë furnizim e konsumatorëve të tjerë . Sistemi i tubave të ujit sanitar kërkon gjitha kërkesat e normave dhe standarteve të përcaktuar. I gjithë rrjeti i shpërndarjes do të termoizolohet për të eleminuar fenomenin e kondensimit dhe do të pajiset me saraçineska ndërprerës aty ku është e nevojshme, në rast ndërhyrje të mundshme apo riparim që mund të kërkohen. Sistemi i tubove të ujit sanitar do të plotesojë kërkesat e normave dhe standarteve të përcaktuar dhe seleksionuar qysh në fazën e projektimit prej stafit inxhinierik si dhe të kërkesave paraprake të investitorit. Tubat duhet të jenë të qëndrueshëm ndaj goditjeve mekanike dhe rezistent ndaj agjentëve atmosferik. Tubot e këtij sistemi janë ndarë në funksion të materialit të tyre si më poshtë:

- Tubo çeliku të zinkuar pa tegel për kolonat;
- Tubo PE–Xa – (Polyetilen i retuikuluar) për shpërndarjen në kate;
- Tuba PPR;
- Tuba PEHD (polietilen me densitet të lartë).

Përpara përdorimit uji sanitar duhet të trajtohet (filtrohet) në bazë të karakteristikave fiziko kimike që ka. Filtrimi mund të jetë:

- Me filtër mekanik;
- Me filtër kartuç;
- Me filtër me rërë;
- Me filtër me karbon;
- Me filtër me ultraviolet.

Impianti i furnizimit me ujë të ngrohtë sanitar

Uji I ngrohte sanitar duhet pergatitur me sistem panelesh diellore per uje te ngrohte, ku duhet marre parasysh se paku 1 m2 panel diellor per cdo 100 litra uje te ngrohte ne dite. Panelet mund te jene ose me system termosifon, pa rezistence elektrike por i projektuar ne menyre te tille qe depozita e panelit te furnizoje direkt boilerin ne tualet, ose me sistem qendror me qarkullim me pompe. Specifikimet minimale te paneleve per tu plotesuar

Akumulimi i ujit të ngrohtë duhet të ketë temperaturë jo më të vogel se 60 °C. Megjithatë, për sigurinë e fëmijeve, për reduktimin e rrezikut nga temperatura shumë e lartë e ujit, rregulloret e ambienteve për kopeshte kërkojnë që temperatura për përdorim (në dalje të pajisjeve hidro-sanitare) nuk duhet të jetë më e lartë se 43 °C për të gjitha pajisjet e ujit të nxehtë. Një gjë e tillë arrihet nëpermjet përzjeries termostatike që kryen mishelatori

Dimensionimi i rrjetit të ujit të ngrohtë sanitar duhet të bëhet në bazë të norma dhe standarteve të projektimit.

Sistemi i ujit sanitar do të shërbejë për të siguruar ujin e ftohtë dhe të ngrohtë nga stacioni i pompimit tek kolektorët dhe mbas kësaj të sigurojë shpërndarjen e ujit në pajisjet e ambienteve sanitare.

Shperndarja e ujit të ngrohtë sanitar realizohet nëpërmjet:

- Linjat e shpërndarjes se ujit të ngrohtë;
- Riqarkullimi i ujit të ngrohtë (nese do zgjidhet varianti me boiler qendror te ujit te ngrohte)
- Kolektoret e furnizimit me ujë (nese do zgjidhet varianti me kolektor nga projektuesi)

86.13 Projekti i plotë i kanalizimeve

Sistemi i shkarkimit të ujrave në tërësinë e tij përmban rrjetin e mbledhjes se ujrave atmosferike,ujrave te zeza, ujrave gri dhe ujrave me permbajtje yndyrore.

- Ujrat atmosferike quhen ujrat që bien mbi sipërfaqen e tokës në formën e reshjeve të lëngëta(shiut) dhe në formë të ngurtë (breshër dhe dëborë).
- Ujrat e zeza quhen të gjithë ujrat që mblidhen nga rrjeti shkarkimit të ujrave të ëc të gjithë shkollave.
- Ujrat gri janë të gjithë ujrat që mblidhen nga rrjeti shkarkimit e lavamaneve, bideve, dusheve, lavatriceve etj.
- Ujrat me përmbajtje yndyrore mblidhen nga rrjeti shkarkimit të të gjithë kuzhinave të godinave të ndryshme.

Në rrjetin e shkarkimit të ujrave në të cilat kemi prani të ujrave yndyrore instalohet impianti i mbledhjes se yndyrerave përpara derdhjes në kolektorin kryesor të shkarkimit të ujrave të zeza.

86.13.1 Dimensonimi i rrjeteve të sistemit shkarkimit, vlerat normative të shkarkimit

Dimensionimi i rrjetit të shkarkimit të ujrave bëhet duke u bazuar në llogaritjen e prurjeve për njësi të shkarkimit të paisjeve të ndryshme, në shpejtësinë e rrjedhjes së lëngjeve në tuba dhe pjerrësia e tubacionit. Rrjedhja e ujit në sistemin e shkarkimit duhet të mos krijojë presione që krijojnë grushte hidraulike në tubacione.Tubat duhet të kenë një diametër të mjaftueshëm që të lejojnë qarkullimin e lirë të ventilimit të ajrit e cila stabilizon presionin e rrjetit.

86.13.2 Vlerat e njësi të shkarkimit sipas aparateve

Çdo pajisje sanitare ,shtë e karakterizuar nga një normë e caktuar e rrjedhjes së ujit, e cila varet nga madhësia dhe kushtet e funksionimit te saj. Normat e dimensonimit në te cilat bazohemi per rrjetin e shkarkimit janë propozuar nga standartet **UNI 9183.**

Tabela 1 – Vlera për njësi shkarkimi për aparaturat (UNI 9183)

Aparaturat	**Njesi shkarkimi**
Vaske (pa dush)	2
Dush (për nje sifon)	2
Dush (për cdo sifon të instaluar bashkë)	3
Lavaman	1

Bidet	2
ËC me kaset	4
ËC me kasetat të futur në mure	8
Lavaman kuzhine	2
Lavaman	3
Lavastovile	2
Lavatrice	2
Pilet dyshemeje	1
Kombinim Lavaman-Bide-Vaske-ËC me kaset	7
Kombinim Lavaman-Bide-Vaske-ËC me kaset të futur në mure	10
Kombinim Lavaman-ËC me kaset	4
Kombinim Lavaman-ËC me kaset të futur në mure	8

Dimensioniet e degëzimeve.
Rrjeti i brendshëm i mbledhjes së ujrave të shkarkimeve të ujrave të zeza është i përbërë nga degëzimet e të gjitha paisjeve sanitare.Nga rrjeti i brendshëm uji dërgohet në kollonën vertikale të shkarkimit. Prurja në një degë është prurja njësi e aparatit i cili do të shkarkojë në degëzim. Diametri percaktohet duke u bazuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2 – Diametri i degëve të shkarkimeve në raport me numrin maksimal të njësive të degëve të shkarkimeve në to (UNI 9183).

Diametri i degëve (mm)	**Ngarkesë totale**
40	3
50	6
65	12
80	20
100	160
125	360
150	620
200	1400

86.13.3

86.13.4 Dimensionet e kolonave të shkarkimit

Një kollonë shkarkimi zakonisht merr degë të ndryshme në kate të ndryshme. Prurjet maksimale e rrjedhjes në një kolonë shkarkimi rriten me rritjen e kateve në të cilat ka degëzime. Për dimensionimin e tubacionit të kollonës vertikale të shkarkimit meret prurja maksimale e rrjedhjës në kollone.

Tabela 3 – Diametrat e kolones se shkarkimit ne raport me numrin maksimal per njesi shkarkimi, numri i kateve dhe ngarkeses ne njesit e shkarkimit te katit me te ngarkuar (UNI 9183)

Diametrat e	**Ndërtuar deri në**	**Ngarkes maksimale**

kollonave (mm)	3 kate	për një kate
50	10	6
65	20	9
80	30	16
100	240	90
125	540	200
150	960	350
200	2200	600
250	3800	1000
300	6000	1500

86.13.5 Ventilimi i rrjeteve të shkarkimit

Ventilimi i rrjetit të ujrave të zeza ka si qëllim kryesor nxjerrjen jashtë të gazrave që mblidhen nga ujrat e zeza, gjithashtu nxit funksonimin normal të sifonit të instaluar në cdo pajisje dhe mbajtjen e tyre nën presion atmosferik. Një sistem efektiv ventilimi është gjithashtu i dobishëm për të penguar formimin e mykut.

Kolonat e ventilimit i ndajmë në katër kategori

- Ventilimi primar
- Ventilim të drejtpërdrejt paralel
- Ventilim paralel I indirekt
- Ventilim sekondar

86.13.6 Përpunimi i ujrave të shkarkimeve

- Përpunimi i ujrave të zeza është një procesi i heqjes së ndotësve përbërës në këto ujra.
- Përpunimi i ujrave të zeza bëhet nëpërmjet ndërtimit të impianteve të pastrimit të ujrave.
- Këto impiante ndërtohen jashtë qëndrave të banuara.
- Pas pastrimit këto ujera merren për përdorim komunal.
-

86.13.7 Materialet e tubave dhe komponenteve kryesor të rrjetit të shkarkimit

Tubacionet e degëzimeve të rrjetit të brendshëm dhe të kollonës të shkarkimeve të ujrave të zeza përdoren nga meteriale të ndryshme, tubacione me presion: geberit me saldim.

tubacione pa presion :Polietilen dhe PVC

Tubacinet e kolektorëve ndahen në tubacione me ngarkesë dhe tubacione pa ngarkesë.

Kur tubacionet kalojnë ne trotuare ose lulishte përdoren tuba të brinjëzuar pa ngarkesë SN4, PVC SN4.

Kur tubacionet kalojnë në trupin e rrugës në të cilën ka ngarkesa dinamike dhe kalojnë makina me tonazh të lartë përdoren tuba të brinjëzuar me ngarkesë SN8, PVC SN8. Materialet duhet të shoqërohen me certifikatat e prodhimit.Bazuar në normat **UNI 9183** dhe **UNI EN 1091.**

Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut

- Dimensionimi i rrjeteve të shkarkimit të çative dhe tarracave.
    - Dimensionimi i ullukëve.
    - Dimensionimi i kollonave zbritëse.
    - Dimensionimi i kolektorëve të tubacioneve.
    - Dimensioni i drenazhimit sipërfaqsor.
- Impiantet e shkarkimit të ujrave të bardha.
    - Ujrat e kondensës.
    - Ujrat aksidentale nga impianti M.K.Z.
    - Ujrat në katet nëntokë, nga infiltrimet etj.
- Rrjetet e shkarkimit të ujrave të shiut dhe elementëve kryesorë.
- Materialet e tubave dhe elementët kryesorë impiantistikë.
- Ruajtja dhe përdorimi i ujrave të shiut.

86.14 Projekti i plotë i mbrojtjes kundra zjarrit dhe shpetimit (MKZSH)

Ky impiant përfshin tërësinë e masave arkitektonike, konstruktive, mekanike dhe elektrike për “Parandalimin, mbrojtjen dhe ndërtimin e Impianteve të Mbrojtjes Kundër Zjarrit”.
Këto masa sipas funksionit dhe mënyrës së aplikimit ndahen në masa të “Mbrojtjes Pasive“ dhe në masa të “Mbrojtjes Aktive”.

- Mbrojtja Pasive, e cila trajton argumentat arkitektonik dhe konstruktiv të parandalimit dhe mbrojtjes nga zjarri, te tilla si Kompartimentizimi i strukturave; Realizimi i rrugëve, shkallëve dhe daljeve të sigurta të shpëtimit; Reduktim i ngarkesës së zjarrit dhe përhapjes së tij. Mbrojtja pasive është subjekt i projekteve arkitektonike dhe konstruktive.
- Mbrojtja Aktive, e cila trajton impiantet e dedektimit e shuarjes së zjarrit, te tilla si impiantin e dedektimit dhe të sinjalizimit në rast zjarri, impiantet e shuarjes së zjarrit, të tipit manuale, impiantin e kontrollit të tymit dhe nxehtësisë. Impiantet e dedektimit do të trajtohen nga impiantet elektrike.

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri do jete me hidrante. Hidrantet duhet te jene te projektuar per prurjen dhe presionin e nevojshem sipas standarteve dhe te jene te kompletuar me te gjithe elementet (kaseta, saracineska, tubi i gomuar etj). Ato duhet te pozicionohen ne menyre te tille qe cdo pike e objektit te mbulohet nga te pakten dy hidrante dhe duhet te jene te vendosur sa me prane rrugeve te kalimit te shpetimit dhe evakuimit (objekti duhet te kete se paku dy rruge te shpetimit dhe evakuimit). Ne rast se ndertesa do kete me shume se nje kat, ne hidrantet e secilit kat duhet vendosur nje valvul per lidhjen e skuadrave te zjarrfikesit.
Hidrantet e brendshem duhet te instalohen në mënyrë të tillë që:

- Të instalohen si të pavarur për cdo kompartimentizim;
- Të pozicionohen në afërsi të daljeve e rrugëve të shpëtimit pa u bërë pengesë;

- Të jenë të pozicionuar në të dy anët e portës nëse ka porte REI;
- Të mbulojnë cdo hapesirë të aktivitetit;
- Cdo hidrant të mbrojë një zone me sipërfaqe deri ne 1000 m²;
- Cdo pikë e zonës së mbrojtur të jetë në distancë maksimale 20 m për hidrantet mural dhe 30 m për naspot;

Hidrantët e zjarrit të jashtëm duhet te jene të tipit kollonë mbi tokë me prurje 350 l/m dhe presion në dalje jo më të vogël se 2.5 bar, janë të përbërë nga një kollonë që del nga nëntoka në të cilën janë pozicionur lidhjet që mundësojnë furnizimin e ujit. Hidranti është i përbërë nga kollona me dy dalje perkatësisht DN 70 dhe DN 100 me tapa të lidhura me zinxhir, dhe çelës manovre (opsional).
Hidrantete kollone siper toke dhe hidrantet nëntoke duhet të instalohen në menyrë të tillë që :

- Të jenë jo më shumë se 60 m larg nga njëri tjetri;
- Jashtë ndërtesës rekomandohet që të përdoret hidrante kollonë sipër toke;
- Aty ku është e mundur të instalohen në korrespodencë me daljet nga ndërtesa në menyrë të tillë që të rezultojnë në pozicion të sigurtë edhe në rast zjarri;
- Distanca e tyre nga muret e jashtme të godinës që mbrojnë varet edhe nga lartësia e saj, por rekomandohet një distancë midis 5 m dhe 10 m .

Lidhja me autopompën është një paisje që ndihmon në shuarjen e zjarrit e lidhur me rrjetin hidrik nëpërmjet të cilës mund të sigurohet ujë për rrjetin hidrik në rast emergjence zjarri. Çdo lidhje me autopompen duhet të sigurojë :

- 1 apo 2 lidhje me diameter jo më të vogël se DN 70;
- Të jetë e fiksuar mirë në muret anësore jashtë godinës, lehtesisht i identifikueshem dhe te ketë akses për makinën e zjarrfikëse;
- Presion në dalje jo më të vogël se 1.2 Mpa.

Rrjeti i furnizimit me ujë duhet të jetë në gjëndje që të sigurojë në cdo kohe prurjen dhe presionin e nevojshëm të kerkuar nga impianti në rast zjarri. Si burim uji mund të shërbeje

- Lidhje fikse nga rrjeti ujësjelles i qytetit i pandërprerë;
- Rezervuare fiks të pashtershme, me sasinë e nevojshme të ujit disponibël në cdo kohë.

Si burim apo rezerve ujore nuk mund të shërbejnë puset, shatërvanet apo lidhje të tjera jo të sigurta. Duhet të merren masa qe uji që shërben si rezervë të mos ketë :

- Alga, apo materiale të tjera sospense(bllokuese)
- Materiale korrozive;

Grupi i pompimit duhet të i pozicionuar në një ambient të mbrojtur, në një nivel me rezervën ujore dhe duhet të kompozohet nga :

- 1 ose 2 pompa sipas normës EN733 së bashku me pompën pilot (jockey) dhe disel.
- Paneli komandimit i paisur me buton në pjesën ballore dhe ekranin LCD.

Duhet të merren masa që furnizimi me energji elektrike të bëhet si nga rrjeti normal edhe nga motogjeneratori.

Rrjeti i shperndarjes përfshin rrjetin nëntokësor, rrjetin e jashtëm në dukje dhe rrjetin e brendshëm të godinës. Preferohet të jetë rrjeti unazor, i pajisur me valvola ndërprerëse kontrolli.
Rrjeti i shpërndarjes duhet të marrë parasysh :

- Të jetë me materiale sipas normave;
- Të jenë të lyer me bojë antindryshk;
- Të jetë i mbrojtur nga zjarri, dëmtimet dhe ngricat;
- Të sigurojnë rezistence mekanike;
- Të merren masa për zonat sizmike, kalimet në mure apo ndarje antizjarr.

Projekti i MNZSH duhet te percaktoje gjithashtu edhe pozicionet dhe pajisjet e nevojshme per evakuimin e tymit (baxho me hapje automatike, ventilatore per nxjerrjen e tymit etj).
Projekti i MNZSH duhet gjithashtu te perfshije sinjalistiken e evakuimit.
Sinjalistika shërben për të ndihmuar personat të gjejnë rrugët e shpëtimit, daljet e emergjencës, pajisjet e shuarjes së zjarrit apo telefonat e emergjencës. Sinjalistika e zjarrit, dimensionet (në varësi të distancës së shikimit), ngjyrat dhe përmasat e tyre janë të përcaktuara në perputhje me normën EN ISO 7010. Sinjalistika gjithashtu duhet të realizohet edhe me mjete të tjera :

- nëpërmjet një sistemi komunikimi zanor;
- nëpërmjet një sipërfaqeje me konsistencë të ndryshme;
- nëpërmjet një kontrasti kromatik në dysheme të cilat janë të dukshme në të gjitha kushtet e ndriçimit.

20. KONSTRUKSIONI

86.15 konstruktiv **6.1 Standartet për projektin**

STANDARDET REFERUESE

Eurocodet

- EC0 Bazat e projektimit të strukturave
- EC1 Ngarkesat në struktura
- EC2 Projektimi i strukturave b/a
- EC7 Projektimi gjeoteknik
- EC8 Projektimi sizmik i strukturave.

Kushtet shqiptare të projektimit dhe konkretisht

- Kushtet teknike të projektimit KTP -1978
- Kushtet teknike të projektimit për ndërtimet antisizmike KTP-N.2-89

Projektimi i shkollave duhet të bazohet në standartet e projektimit të strukturave, dhe mqs në vendin tonë janë akoma në fuqi Kushtet teknike të projektimit të vitit

1978 -1979, të cilat nuk pasqyrojnë zhvillimet dhe normat e fundit të hartuara për këtë qëellim, rekomandojmë që projektimi i shkollave të bëhet duke u mbështetur në normat e Eurocodeve.
Në eurocode janë të percaktuara me detaje llojet e ngarkesave (të përhershme, të përkohëshme, borë dhe erë si dhe kombinimet e tyre) të cilat duhen marë në konsideratë gjatë analizimit të strukturës.
Përveç kësaj, që duhet të jetë baza në projektimin e strukturave të shkollave theksojmë :

Përpara hartimit të projektit duhet të bëhet studim gjeollogjik dhe sizmik për terrenin në të cilin ndërtohet objekti.
Projektimi i shkollave të bëhet me struktura b/a, dhe marka e betonit të përdorur të mos jetë më e vogël se C25/30, ndërsa Çeliku i përdorur të jetë i markës S500 (sidenor) ose ekuivalent me të
(p.sh FeB44k).

Gjithashtu rekomandojmë që themelet dhe shkollave të jenë pllaka b/a, të hidroizoluar nga jashtë.

Soletat e ndërkateve të shkollave të jenë soleta monolite, me trarë të thellë.

Shtojca 14

(Shtojce per tu plotesuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

Shtojca 15

[*Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të koncesionit/partneritetit publik privat. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u [s’kualifikuat] për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme

_____

_____

Nëse mendoni se, Autoriteti Kontraktor ka shkelur Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe VKM nr.575, date 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për

vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, gjatë procedurës së koncesionit/ppp, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Ligjin “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” .

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të koncesionit/ppp-ve.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 16

[*Shtojce per tu plotesuar Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data_____]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*
Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:
1._____Vlera *(me numra dhe fjale)* _____
2._____ Vlera *(me numra dhe fjale)* _____
Etj._____Vlera *(me numra dhe fjale)* _____
Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:
1._____
2._____
Perkatesisht per arsyet e meposhtme:
_____
_____
_____

* * *

(Autoriteti Kontraktues) lajmëron [*emri dhe adresa e Ofertuesit fitues*] se oferta e paraqitur më datë [*data*] për marrjen me koncesion te [*emri dhe përshkrimi i përgjithshëm i objektit te kontrates*] është pranuar.

Afati i negocimit te Kontrates tuaj do te jete _____

Ofertuesi [*emri*] kërkohet t’i paraqesë (Autoriteti Kontraktues) dokumentet e meposhtme:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve te Pergjithshme dhe te Vecanta te Kontratës Koncesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.

- Sigurimin e Kontrates sipas formes se kerkuar ne Dokumentat Standarte te Procedures Konkurruese. Sigurimi duhet te paraqitet jo me vone se ne momentin e nenshkrimit te Kontrates nga te dy palet.
- Dokument bankar qe verteton pagesen e kryer per shpenzimet e publikimit dhe shpenzimet e konsulences se specializuar (*ne rast se ka*). Kjo pagese do te kryhet para fillimit te negociatave.
- Ne rast se, terhiqeni nga lidhja e kontrates duhet te njoftoni me shkrim.

…….. *Autoriteti kontraktues*

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo_____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Drejtuesi i Autoritetit Kontraktor]

Shtojca 17

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
Punët

Neni 1: Qëllimi

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruara ne bazë të legjislacionit të koncesionit/partneritetit publik privat.

1.2 Ligji për koncesionet/partneritetin publik privatnë Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat ekoncesionit/partneritetit publik privat. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.

1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.2 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.

2.3 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese,

2.4 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

2.5 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

2.6 “Data e fillimit” eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

2.7 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

2.8 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

2.9 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.10 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.11 “Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.

2.12 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontrakton punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.13 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.

2.14 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

2.15 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

2.16 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

2.17 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

2.18 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

2.19 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të sherbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtëkoncesion/partneritet publik privat.

4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar qe nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Komunikimi

8.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 9: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

9.1 Kontraktori duhet të bashkepunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit te punimeve.

Neni 10: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

10.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim te rastit kur keto te fundit, kishin gabime te dukshe qe mund te ishin konstatuar lehtesisht nga kontraktuesi.

Neni 11: Kontraktori që Kryen Punimet

11.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

11.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

11.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 12: Ekzekutimi i Punimeve

12.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 13: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

13.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

13.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 14: Zbulimet

14.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen per te vepruar konform legjislacionit ne fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë autoritetin kontraktor për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhezimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 15: Disponimi i Kantierit

15.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 16: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

16.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe

ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 17: Forca Madhore

17.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontrates, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

17.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

17.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere autoritetin kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 18: Negociatat dhe Amendamentet

18.1 Kontratat e parashikuara me këtë ligj mund të ndryshohen duke i shtuar kontratës një aneks, me kusht që kjo mundësi të parashikohet në dokumentacionin e tenderit dhe në kontratë.

18.2 Ndryshimet në kontratë bëhen nga autoriteti kontraktues dhe koncesionari /partneri privat.

18.3 Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve;

b) kur humbet objekti i kontratës ose kur ekziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në rastin e forcës madhore;

c) gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor;

ç) në raste të tjera që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve, ose në realizimin e kontratës.

18.4 Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë kontratën kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.

18.5 Pa shkelur dispozitat e neneve 32 dhe 33, të ligjit për koncesionet dhe partneritetin public privat termi “kushtet thelbësore” u referohen në veçanti kushteve të cilat, nëse do të kishin qenë të përfshira në njoftimin fillestar të kontratës ose në dokumentacionin e tenderit, do të kishin bërë të mundur që ofertuesit të dorëzonin një ofertë në thelb të ndryshme, si dhe nëse ndryshimet do të kishin tejkaluar

objektin e kontratës në atë masë që këto ndryshime do të përfshinin shërbimet që nuk mbulohen fillimisht.

18.6 Autoriteti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave për të gjitha ndryshimet e planifikuara, të cilat ndikojnë ose krijojnë riskun e ndikimit direkt ose indirekt në buxhetin e shtetit ose në buxhetin e organeve vendore apo të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare siç përcaktohet nga ky ligj.

18.7 Autoriteti kontraktues njofton jo më vonë se 20 ditë Ministrinë e Financave për ndryshimet e bëra në kontratë në përputhje me këtë nen.

Neni 19: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

19.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

19.2 Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 20: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

20.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t’i shërbyer sa më mirë interesit publik.

20.2 Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

20.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuara dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t’i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 21: Nënkontraktimi

21.1 Autoriteti kontraktues mund:

a) t’i kërkojë koncesionarit që të japë kontrata që janë minimalisht 30% e vlerës totale të kontratës së koncesionit te palët e treta, duke siguruar në të njëjtën kohë një mundësi për tenderuesit që ta rritin këtë përqindje, ndërkohë që kjo përqindje minimale specifikohet në kontratën e koncesionit;

b) të kërkojë nga tenderuesit që të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e vlerës totale të kontratës që ata planifikojnë t’u caktojnë palëve të treta.

21.2 Për nënkontraktimin e partneriteteve publike private, që realizohen si kontrata të punëve publike ose të shërbimit publik, zbatohen dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik në përputhje me rrethanat.

Neni 22: Transferimi i të **Drejtave**

22.1 Në përputhje me dispozitat e këtij neni, me pëlqimin paraprak me shkrim nga autoriteti kontraktues, kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat mund të transferohet te një person i tretë që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në bazë të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht, përveç se nëse këto kërkesa u referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e kontratës, për shkak të faktit se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga koncesionari /partneri privat i mëparshëm.

22.2 Transferimi i kontratës së koncesionit nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së kontratës.

22.3 Kur koncesionari/partneri privat është një subjekt për qëllime të veçanta, atëherë ndryshimi i të drejtave të pronësisë apo i menaxhimit të Subjektit për qëllime të veçanta (SPV), si rezultat i transferimit të kapitaleve ose të aksioneve të biznesit, nuk mund të zbatohet pa miratimin e autoritetit kontraktues dhe të Ministrisë së Financave, përveç se nëse ky është një rezultat i tregtimit të rregullt të aksioneve në një treg të rregulluar të kapitalit.

22.4 Autoriteti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave për të gjitha transferimet e planifikuara të kontratës, të cilat ndikojnë ose krijojnë rrezikun e ndikimit në ndonjë mënyrë në buxhetin e shtetit ose në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, ose të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare, siç përcaktohet nga ky ligj.

22.5 Autoriteti kontraktues njofton Ministrinë e Financave për transferimet e kontratës të bëra në përputhje me këtë nen.

Neni 23: Sigurimi i Kontrates

23.1 Brenda _____ ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, kontraktori duhet t’i dorëzoje Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontrates në vlerën dhe formën siç parashikohet në kontratë. Deshtimi për të dhene sigurimin e kontrates në formën dhe në vlerën e kërkuar brenda _____ ditëve do të rezultojë në anullimin e kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës të kontraktorit.

Neni 24: Baza Ligjore

24.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 25: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

25.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

25.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 26: Përfaqësimi i Palëve

26.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

26.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

26.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

Neni 27: Lajmërimet

27.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

27.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 28: Llogaritja e Afateve

28.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Shtojca 18

[*Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

KUSHTET E VEÇANTA
Punët

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. ne rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është _____

1.2 Kontraktori është _____

Neni 2:Sigurimi i Kontrates

2.1 Sigurimi i kontrates në shumën 10 % të vlerës së saj, duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontrates do t’i lëshohet ose kthehet, menjehere, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: _____
_____
_____

Neni 3: Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor

3.1 Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor: _____

3.2 Adresa/pika e kontaktit:_____

Neni 4: Kantieri

4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i sakte i venddodhjes se objektit qe do te realizohet):
_____
_____

Neni 5 Data e Fillimit

5.1 Kjo kontratë: _____
_____

Neni 6: Lloji i Kontratës

_____

Shtojca 19

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*] [

Shtojce per tu paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

[Data_____]

Për : *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emer të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e koncesionit/ ppp: *[lloji i procedurës)*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (*objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimit Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Duke qene se:

- (*emri i Ofertuesit Fitues)* eshte shpallur fitues ne Proceduren Konkurruese per Marrjen me Koncesion/PPP te _____, me vendndodhje ne _____ , sipas shkreses se (*emri i Autoritetit Kontraktor*) (me poshte referuar si "Autoriteti Kontraktor"), Nr. _____Prot, date ___.__.___, "Njoftimi i Fituesit" ; dhe
- Ofertuesi Fitues ka paraqitur prane nesh Draftin e Kontrates te lidhur ndermjet tij dhe Autoritetit Kontraktor, "Per marrjen me koncesion/ppp te_____ ; dhe
- ne Kontraten tuaj kerkohet leshimi i nje Sigurimi Kontrate ne vleren e specifikuar si me poshte, si garanci per permbushjen e detyrimeve te Koncesionarit te parashikuara ne Kontrate; dhe
- (*emri i Bankes/i shoqerise se sigurimit)* eshte dakord te leshoje kete garanci.

Deklarojme se:

- jemi garantuesit e kontrates se siperpermendur deri ne shumën totale prej (*shuma ne shifer dhe fjale)*, shume e cila është e pagueshme ne menyren dhe monedhen e percaktuar ne kontrate ; dhe
- marrim persiper te paguajme, sapo te beni kerkesen e pare me shkrim dhe pa qene nevoja te beni argumentim te kerkeses, cdo shume brenda kufirit prej (*shuma e garancise)*; dhe
- per marrjen e kesaj garancie, nuk eshte nevoja t’i drejtoheni me pareKoncesionarit\Partneritetit Publik Privat per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj; dhe
- asnje shtesë apo ndryshim i kushteve te Kontrates, per te cilen ju mund te bini dakord me Koncesionarin, nuk na cliron nga detyrimet e kesaj Garancie.

Kjo garanci eshte e vlefshme deri ne daten qe perfshin _____ dite nga data e leshimit teCertifikates se Perfundimit.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

Shtojca 20

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I PUBLIKIMIT TE NJOFTIMIT TE KONTRATËS SE NËNSHKRUAR

Seksioni 1 Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____

Adresa _____

Tel/Fax _____

E-mail _____

Faqja në Internet _____

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion Qëndror Institucion i Pavarur

Njesi e Qeverisjes Vendore

Seksioni 2 Objekti i Kontratës

2.1 Lloji i Kontratës

Shërbime

2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës

1.Objekti i kontratës _____

2. Forma e Kontratës _____

3. Burimi i Financimit _____

2. 3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në **muaj** **ose ditë**

ose

duke filluar nga **/ /** me përfundim në **/ /**

<u>Seksioni 3 Procedura</u>

3.1 Lloji i procedurës:

E hapur	E kufizuar	Me negocim me shpallje paraprake

3.2 Numri i ofertave të dorëzuara: **Numri i ofertave të rregullta:**

<u>Seksioni 4 Informacion mbi kontratën</u>

4.1 Numri i Kontratës: _____ **Data e Kontratës/ /**

4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit

Emri _____

Adresa _____

Tel/Fax _____

E-mail _____

Adresa e Internetit _____

4.3 Vlera Totale

Vlera _____(pa TVSH) Monedha _____

4.4 Informacione shtesë (*nëse ka*)

_____

_____

_____

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi / /

Shtojca 21

FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ankesë drejtuar : ***Autoriteti Kontraktor*** ☐

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërish).

_____
Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

_____
Adresa

_____ _____ _____
Qyteti Shteti Kodi Postar/Kodi Zip

_____ _____
Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

_____
E-mail

_____
Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

_____ _____
Firma e zyrtarit të autorizuar Data (viti/muaji/dita)

_____ _____
Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës) Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Seksioni II. Informacion për Procedurën

1. Numër Identifikimi

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë ***llojin e procedurës së përdorur*** *për koncesionin/ppp në fjalë (Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar (PK), Procedurë me Negociim me shpallje paraprake (PN).*

_____

2. Autoriteti Kontraktor

Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e koncesionit/ ppp.

_____

3. Vlera e Përllogaritur e Koncesionit/PPP

Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

_____

4. Objekti i Kontratës

Përshkrim i shkurtër i punëve/ shërbimeve që blihen.

_____

5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

_____

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese

_____

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore e Ankesës

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

_____

2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

_____

3. Lista e Shtojcave

Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë.

Mundësisht bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht ***çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj.*** *Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për koncesionin/ ppp, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

4.Kundërshtimi Paraprak ndaj Autoritetit Kontraktues

Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejpërdrejt autoritetit kontraktues. Bashkangjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.

1. Keni bërë ndonjë kundërshtim të tillë? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (psh, me shkrim, nepermjet faksit, etj).

   Po ☐ **Jo** ☐

   _____

2. Autoriteti Kontraktues pranë të cilit është bërë kundërshtimi

   Emri i autoritetit kontraktues.

   _____

   Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi.

   _____

3. Natyra e Masës së Kërkuar Korrigjuese

   Çfarë mase korrigjuese kërkoni?

   _____

4. Lista

   Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre

dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht ***çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e procedures konkuruese, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë.*** *Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për konkurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë: **Autoriteti perkates sipas ligjit nr. 125/2013 “Per koncensionet dhe partneritetin publik privat”**

Nr. Faks: E-mail:
Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit

Shënim:

Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

Shtojca 22

[*Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik]*

FORMULARI I PROKURËS

Sot më datë, muaji, viti …….

Perpara meje

Noterit/es

I/E nenshkruari/a z./zj. ____
ne cilesine e tij/saj _____

Shtetesia _____
Mbajtes i Pasaportes ose Dokumentit te Identifikimit nr. Leshuar nga _

_____
Me date _____
Banues ne _____

Emeroj z./zj._____ ne cilesine e tij/saj si_____, per te:

(a) nenshkruar ose vulosur dhe per te dorezuar tek autoritetet kompetente te gjithe dokumentet e renditura ne Pasqyrën 1 bashkelidhur;

(b) dorezuar dhe marre ne dorezim cdo lloj dokumenti apo instrumenti ne lidhje me dokumentet e renditura në Pasqyrën 1 bashkelidhur; dhe

(c) Te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme ose shtese ne lidhje me ceshtjet e percaktuara ne kete dokument, perfshire edhe nenshkrimin dhe zbatimin e cdo akti, i cili nevojitet per te zbatuar per te plotesuar dokumentet e listuar ne Pasqyrën 1, ose qe keto dokumente te sjellin pasoja.

Dhe eshte i/e autorizuar te emeroje persona te tjere per te ushtruar te gjitha ose nje pjese te tagrave te percaktuara ne kete Prokure

[i] Shtuar me VKM Nr. 401 date 13.5.2015